Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Raporti i referencimit të KKK-së së Kosovës me KEK-në mbi Arsimin e Përgjithshëm, AAP-në dhe Arsimin e lartë

Prishtinë
Shtator 2014

Raporti i referencimit të KKK-së së Kosovës me KEK-në mbi Arsimin e Përgjithshëm, AAP-në dhe Arsimin e lartë

Ky raport përcakton referenca e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve në Kornizen Evropiane të Kualifikimeve dhe QF / EHEA në përputhje me kriteret dhe procedurat e miratuara nga Grupi Këshillues KEK dhe Bolonjës Follow - Up Group.

Raport i përgatitur nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve

Gjindet ne WEB faqen zyrtare të AKK: www.akk-ks.net

©Copyright: Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve

Ky version i dokumentit është në dispozicion pa pagesë.

Autorët dhe redaktorët: Teuta Danuza, Anton Gojani, Ramë Likaj and Milot Hasangjekaj.

Konsulentët vendorë: Drilona Emrullahu, Ardiana Gashi, Artane Rizvanolli dhe Blerim Haliti.

Konslentët ndërkombëtar: John Hart dhe Michael Graham.

Cover dhe ilustrime: Faton Mikullovci

Mbështetje në konferencën për Raportin e Referencimit: Trevor Clark

Ky publikim është mbështetur nga Këshilli Britanik në Kosovë përmes projketit “ Zhvillimi I Raportit të Referincimit për Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve”

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

BRITISH COUNCIL

Lista e shkurtesave

UA	Udhëzimi Administrativ
AAAPARr	Agjencia për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimin e të Rriturve
KAAP	Këshilli për Arsimin dhe Aftësimin Profesional
SEKAAP	Sistemi Evropian i Kredive për Arsimin dhe Aftësimin Profesional
ENQA	Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë
ECTS	Sistemi Evropian për Transferimin dhe Akumulimin e Kredive
FET	Fondacioni Evropian i Trajnimit
OEK	Oda Ekonomike e Kosovës
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
MASHT	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
NARIC	Qendra Kombëtare për Njohje dhe Informim Akademik
OJQ	Organizatat jo-qeveritare
AKKK	Autoriteti Kombëtarë i Kualifikimeve i Kosovës
KKC	Këshilli Kombëtar i Cilësisë
PTK	Post Telekomunikacioni i Kosovës
AAK	Agjencia e Akreditimit e Kosovës
KKK	Korniza e Kurrikulës së Kosovës
KSHLM	Këshilli Shtetërorë për Licencimin e Mësimdhënësve

Përmbajtja

Lista e shkurtesave 3

Hyrje 9

1. SISTEMI I ARSIMIT TË PËRGJITHSHËM NË KOSOVË 11

1.1 PËRMBLEDHJE 11
1.2 KORNIZA LIGJORE 12
1.3 KUALIFIKIMET E ARSIMIT TË PËRGJITHSHËM 13
1.4 ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE 13
1.5 INSTITUCIONET PRIVATE DHE NË PARTNEREITET TË ARSIMIT TË PËRGJITHSHËM 13
1.6 Sigurimi i cilësisë në arsimin e përgjithshëm 14

2. AAP-TË DHE SISTEMI I AFTËSIMIT TË TË RRITURVE 15

2.1 PËRMBLEDHJE 15
2.2 Korniza ligjore për AAP dhe sistemin e arsimit për të rriturit 15
2.3 Struktura e sistemit të AAP-së 17
2.4 Kualifikimet, certifikimi dhe progresioni 18
2.5 Ofruesit e AAP-së 20
2.6 Sigurimi i cilësisë në AAP dhe arsim e të rriturve 20

3. Sistemi i arsimit të lartë në Kosovë 21

3.1 Pasqyra e sistemit të arsimit të lartë në Kosovë 21
3.2 Korniza ligjore 22
3.3 Struktura e programeve të arsimit të lartë 23
3.4 Kualifikimet, certifikimi dhe progresioni 23
3.5 Ofruesit e arsimit të lartë 24
3.6 Sigurimi i cilësisë 25

4. Korniza Kombëtare e Kualifikimeve të Kosovës (KKK) 26

4.1 Zhvillimi i KKK-së 26
4.2 Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) 27
4.3 Korniza Kombëtare e Kualifikimeve 28

5. Referencimi i KKK-së së Kosovës me KEK 31

5.1 Procesi i referencimit: 31
5.2 Kriteret e referencimit 31

Kriteri 1: Përgjegjësitë dhe/ose kompetenca ligjore e të gjitha organeve përkatëse kombëtare të përfshira në procesin e referencimit, duke përfshirë Pikën Koordinuese Kombëtare, janë përcaktuar në mënyrë të qartë dhe janë publikuar nga autoritetet kompetente publike. 31

Kriteri 2: Ekziston një lidhje e qartë dhe e dukshme ndërmjet niveleve të kualifikimit në Kornizën, ose Sistemin Kombëtar të Kualifikimeve dhe përshkruesit e niveleve të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve. 32

Kriteri 3: Korniza kombëtare, ose sistemi i kualifikimeve dhe kualifikimet e saj, janë të bazuara në parimin dhe objektivin e rezultatit e të nxënit dhe të ndërlidhura me rregullimet për validimin e mësimit jo-formal dhe informal, si dhe të sistemeve të kredive, aty ku ato ekzistojnë..... 41

Sistemi i arsimit të përgjithshëm 42

Sistemi i AAP dhe arsimit për të rritur 42

Përdorimi i standardeve profesionale 42

Kriteri 4: Procedurat për përfshirjen e kualifikimeve në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve ose për përshkrimin e pozitës së kualifikimeve në sistemin kombëtar të kualifikimit janë transparente..... 46

Kriteri 5: Sistemi(et) kombëtar i sigurimit të cilësisë për arsim dhe aftësim i referohet Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, ose sistemit dhe janë në përputhje me parimet dhe udhëzimet përkatëse evropiane. 48

Kriteri 6: Procesi i referencimit duhet të përfshijë marrëveshjen e deklaruar të organeve relevante të sigurimit të cilësisë 50

Kriteri 7: Procesi i referencimit duhet të përfshijë ekspertët ndërkombëtar..... 50

Kriteri 8: Organi, ose organet kompetente kombëtare duhet të vërtetojnë edhe referencimin e Kornizës kombëtare, apo sistemit me KEK. Organet kompetente kombëtare, përfshirë Pikën Koordinuese Kombëtare, duhet të publikojnë një raport gjithëpërfshirës, i cili përcakton edhe referimin dhe provat mbështetëse, si dhe duhet të adresojë veçmas secilin kriter..... 51

Kriteri 9: Platforma zyrtare e KEK duhet të mirëmbajë një list publike të shteteve anëtare që e kanë konfirmuar se e kanë përfunduar procesin e referencimit, duke përfshirë lidhjet e raporteve të përfunduara të referencimit..... 51

Kriteri 10: Pas procesit të referencimit, dhe në përputhje me afatet e përcaktuara në rekomandim, të gjitha certifikatat e reja të kualifikimit, diplomat dhe dokumentet e Europass, të lëshuara nga organet kompetente, përmbajnë një referencë të qartë, përmes sistemeve kombëtare të kualifikimeve, në nivelin e duhur të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve..... 52

Referencat..... 53

Shtojcat..... 54

Shtojca 1: Angazhimi i palëve të interesuara në zhvillimin e raportit të referencimit..... 54

Shtojca 2: Modeli i Shtojcës së Diplomës për arsimin e lartë..... 58

Shtojca 3: Kushtet për akreditim në arsimin e lartë. 61

Shtojca 4: Lista e institucioneve të akredituara, kualifikimet e miratuara, si dhe standardet e konfirmuara/verifikuara profesionale. 64

Shtojca 5: Modeli i një standardi të profesionit. 66

Hyrje

Qeveria e Republikës së Kosovës synon të krijojë një shoqëri të bazuar në dije dhe të krijojë një sistem gjithëpërfshirës të arsimit që ofron kushte për arsim dhe aftësim cilësor të të gjithë individëve, duke përfshirë dhe promovuar në mënyrë aktive të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe vlerat e shoqërisë demokratike.

Me qëllim të modernizimit të modelit të udhëheqjes së arsimit dhe aftësimit, si dhe në përpjekje të adaptimit të sistemit arsimor me trendet e reja sociale dhe ekonomike, janë ndërmarrë një sërë iniciativash, të cilat e kanë rritur rolin e autoriteteve kombëtare, partnerëve socialë dhe organizatave të shoqërisë civile.

Zhvillimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) është një nga mjetet kryesore reformuese të sistemit tonë arsimor. Ajo është themeluar në vitin 2011 dhe ka për qëllim të përmirësojë qasjen në punë dhe mësimdhënien e mëtejshme duke i bërë kualifikimet relevante me punësimin dhe të mësuarit, si dhe plotësimin e nevojave të nxënësve, ekonomisë dhe institucioneve të arsimit dhe aftësimit. KKK-ja gjithashtu synon të krijojë një bazë për bashkëpunimin dhe njohjen reciproke me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve për të mësuarit gjatë gjithë jetës (EQF).

Edhe pse Kosova zyrtarisht nuk është pjesë e EQF-së (Korniza Evropiane e Kualifikimeve), ky raport dhe procesi, i cili e ka gjeneruar atë, flet për përafrimin e KKK-së me EQF-në. Ky raport mbështet krahasimin e kualifikimeve të Kosovës me ato të shteteve anëtare të BE-së.

Ky raport do të dorëzohet tek Komisioni Evropian në Bruksel nga Ministri i Arsimit, Z. Buja. Ne do të kërkojmë që të prezantohet në një takim të Grupit Këshillues të EQF-së.

Në vitin 2013, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK), ka filluar procesin e referimit me qëllim që të identifikojë lidhjet në mes të niveleve të KKK-së dhe EQF-së, gjë që ka rezultuar me hartimin e raportit të referencimit.

Ky raport i referencimit synon të paraqes lidhjet në mes të niveleve të KKK-së dhe EQF-së duke përshkruar qartë nivelet ekzistuese të kualifikimit ashtu siç zbatohen në sektorët e sistemit të arsimit në Kosovë. Për më tepër, raporti ofron informata mbi 10 kriteret e cilësisë, të cilët janë vendosur për referencimin e KKK-me EQF-në. Procesi i referencimit është kryer në konsultim të ngushtë me të gjitha grupet e akterëve relevant në secilin sektorë të arsimit në Kosovë dhe raporti është rishikuar nga ekspertët ndërkombëtarë.

1. SISTEMI I ARSIMIT TË PËRGJITHSHËM NË KOSOVË

1.1 PËRMBLEDHJE

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) është përgjegjëse për promovimin e sistemit jo-diskriminues arsimor, në të cilin të drejtat e secilit person për arsim dhe/apo aftësim respektohen duke vënë në dispozicion mundësi të barabarta të të mësuarit për të gjithë.

Arsimi i përgjithshëm në Kosovë në përgjithësi zgjatë dymbëdhjetë vite, nëntë prej të cilëve janë arsim i detyrueshëm dhe tre janë arsim i mesëm i lartë.

Arsimi i detyrueshëm fillon kur një fëmijë e arrin moshën gjashtë vjeçare, e cila është mosha minimale për arsim dhe përfundon me mbarimin e arsimit të mesëm të ulët në moshën katërmbëdhjetë vjeçare. Arsimi parashkollor fillon në moshën 5 vjeçare dhe nuk është i detyrueshëm.

Arsimi i përgjithshëm në Kosovë përbëhet nga:

Arsimi parashkollorë dhe para-fillor: mosha 0-6 vjeç – (Para-fillor-21.383 nxënës; para-shkollor-5,389 nxënës)

Arsimi fillor (Klasa 1-5): Mosha: 6-10 (288.378 nxënës)

Arsimi i mesëm i ulët (Klasa 6-9): Mosha: 11-14 (Fillor/I mesëm i ulët-280,596 nxënës)

Arsimi i mesëm (Gjimnazi, Klasa 10-12): Mosha: 15-17- (102,213 nxënës)

Korniza e Kurrikulës së Kosovës (KKK) rregullon arsimin para-shkollorë dhe arsimin e përgjithshëm të detyrueshëm. Ajo është e dizajnuar në gjashtë shkallë kryesore, të cilat paraqesin periudhat me karakteristika të përbashkëta të zhvillimit të fëmijëve dhe kërkesave kurrikulare. Shkallët kryesore përfundojnë në klasat 2, 5, 7, 9, 11 dhe 12. KKK-ja mbulon arsimin para-shkollorë, fillorë dhe të mesëm dhe kërkon nga institucionet përkatëse të ndjekin disa parime mbështetëse në ofrimin e arsimit. Këto janë: arsimi cilësor për të gjithë, gjithëpërfshirje, mësimdhënie me nxënësin në qendër, qasjet e bazuara në kompetencë, fleksibilitet dhe mobilitet, transparencë dhe llogaridhënie.

Arsimi kompenzues i ofrohet të rriturve, të cilët marrin kualifikimet dalëse për mbarimin e programeve të ofruara. Këto përfshijnë nxënien e përshpejtuar për ata, të cilët nuk e kanë përfunduar arsimin fillor, apo të mesëm, apo të cilët nuk kanë ndonjë kualifikim në sistemin formal të arsimit. Ekzistojnë edhe programet e bazuara në njohuritë dhe aftësitë e përgjithshme (duke përfshirë edhe shkrim-leximin, numërimin dhe aftësitë personale dhe teknologjike), të cilat kanë për synim që të përgatisin individin për të hyrë në tregun e punës, apo të vazhdoj shkollimin. Aktualisht këto nuk qojnë drejt kualifikimeve.

Arsimi për nxënësit me nevoja të veçanta organizohet në shkolla të veçanta, klasë të bashkangjitura dhe në klasë të rregullta. Janë shtatë (7) shkolla të arsimit të veçantë dhe së paku 2 klasë të bashkangjitura për komunë në shkollat e rregullta në Kosovë. Nxënësit e verbër dhe ata me të pamur të dëmtuar kanë të drejtë që të marrinë udhëzime në përdorimin e alfabetit të Brajit dhe mjeteve të nevojshme teknike. Për më tepër, gjuha e shenjave të Kosovës është gjuha zyrtare për personat e shurdhër, e cila u mësohet fëmijëve të shurdhër në shkollat e arsimit të veçantë.

Gjuha kryesore e mësimdhënies është gjuha shqipe, por arsimi ofrohet edhe në gjuhë të tjera. Gjuhët e njohura zyrtarisht janë gjuha boshnjake, turke dhe serbe, për shkak të komuniteteve pakicë, të cilët jetojnë në Kosovë.

1.2 KORNIZA LIGJORE

Korniza ligjore për arsimin e përgjithshëm përbëhet nga Ligjet, Udhëzimet Administrative (UA) dhe Strategjitë Kombëtare.

Ligjet

- Ligji Nr.02/L-52/2006 mbi Edukimin parashkollor-
- Ligji Nr.04/L –032–2011 për Arsimin para-universitar
- Ligji Nr. 03/L-068 –2008 për Arsimin në komunat e Kosovës
- Ligji Nr.2004/37–2004 për Inspeksionin e arsimit në Kosovë
- Ligji Nr.03/L-018 –2008 për provimin përfundimtarë dhe provimin e maturës shtetërore
- Ligji Nr.04/L-143–2012 për arsimin dhe aftësimin për të rriturit në Republikën e Kosovës

Udhëzimet Administrative (UA)

- Udhëzimi Administrativ, 15/2013 për financimin e zhvillimit profesional të mësimdhënësve
- Udhëzimi Administrativ 17/2013 për provimet dhe vlerësimet
- Udhëzimi Administrativ 18/2013 për përdorimin e planit individual të arsimit
- Udhëzimi Administrativ 23/2013 për qendrat burimore
- Udhëzimi Administrativ 27/2013 për aktivitetet jashtëshkollore
- Udhëzimi Administrativ 20/2013 pilotimin e kornizës së Kurrikulës dhe Kurrikulës bërthamë
- Udhëzimi Administrativ 07/2012 për vlerësimin profesional të fëmijëve me nevoja të veçanta edukativo-arsimore
- Udhëzimi Administrativ 11/2012 për kriteret për licencimin e institucioneve arsimore në nivelin fillor, të mesëm të ulët, të mesëm të lartë dhe aftësimin profesional
- Udhëzimi Administrativ 12/2012 për kriteret për zgjedhjen e asistentëve dhe instruktorëve për arsim gjithëpërfshirës dhe obligimet e tyre
- Udhëzimi Administrativ 19/2012 për themelimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos-regjistrimit në arsimin e obliguar
- Udhëzimi Administrativ 26/2012 për kualifikimet për personelin që punon me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.
- Udhëzimi Administrativ 06/2011 për Licencimin dhe regjistrimin e institucioneve edukative-arsimore parashkollore private
- Udhëzimi Administrativ 05/2010 për licencimin e mësimdhënësve
- Udhëzimi Administrativ 04/2010 për kriteret dhe procedurat e akreditimit të programeve të zhvillimit profesional të mësimdhënësve
- Udhëzimi Administrativ 06/2008 për qasjen e fëmijëve në institucionet parashkollore
- Udhëzimi Administrativ 18/2004 për licencimin e mësimdhënësve dhe administratorëve të edukimit

Strategjitë kombëtare

- Strategjia për zhvillimin e arsimit parauniversitar në Kosovë 2007-2017
- Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2011-2016
- Strategjia për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas në Kosovë 2007– 2017

- Plani Strategjik për Organizimin e Arsimit Gjithpërfshirës2010 – 2015.
- Plani Strategjik kombëtar për parandalimin e braktisjes (2009 -2014).
- Strategjia për Arsimimin e të Rriturve (2005-2015)

1.3 KUALIFIKIMET E ARSIMIT TË PËRGJITHSHËM

Megjithëse aktualisht nuk ka kualifikime shkollore në Nivelin 1, ky nivel mund të lidhet me njohjen e niveleve më të ulëta të aftësive, të cilat nevojiten për funksionimin në punë, apo në shoqëri. Mund të përfshijë sigurimin e aftësive themelore (p.sh. shkrim-leximin dhe numërimin) që janë ekuivalente me rezultatet e arsimit fillor.

Dëftesat, apo provimi i semi-maturës mund të jenë një standard i kualifikimit në nivelin 3 të KKK-së, ndërsa diploma e maturës mund të jetë një standard i kualifikimit në nivelin 4 të KKK-së.

1.4 ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE

Licencimi i mësimdhënësve, zhvillimi i standardeve për zhvillim profesional, si dhe vlerësimi i performancës është përgjegjësi e MASHT-it, që vepron sipas këshillave dhe rekomandimeve të Këshillit Shtetërorë për Licencimin e Mësimdhënësve (KSHLM).

Të gjitha programet që çojnë drejt kualifikimit të mësimdhënies duhet të jenë ekuivalent me një cikël të programit të arsimit të mesëm të lartë, me 300 ECTS pikë, dhe duhet të përbëhet si nga studimet akademike ashtu edhe nga aftësimet profesionale dhe praktika. Ministria përmes legjislacionit, ashtu siç rekomandohet nga KSHLM-ja, i përcakton: kriteret për kualifikimin e mësimdhënësve, përfshirë këtu nivelin specifik të kualifikimit për fazat e veçanta të arsimit para-universitar; procedurat për sjelljen e kualifikimeve të mësimdhënësve,ekzistues në sistem, në të njëjtin standard që nevojitet për zhvillimin profesional të mësimdhënësve, deri në gusht të vitit 2020; kërkesat për zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe përformanca që ndërlidhet me kërkesat e licencimit; standardet dhe procedurat për akreditimin e programeve për zhvillim profesional të mësimdhënësve; dhe standardet për praktikën profesionale të mësimdhënësve.

1.5 INSTITUCIONET PRIVATE DHE NË PARTNEREITET TË ARSIMIT TË PËRGJITHSHËM

Çdo institucion arsimor privat, apo në partneritet publiko-privat, që ofron arsimim të përgjithshëm duhet të licencohet nga MASHT-i. Standardet qeveritare për licencim bazohen në shumëllojshmërinë e metodave të mësimdhënies dhe mësim-nxënies që përdoren nga këto institucione, shmangien e rrezikut për fëmijët dhe stafin, si dhe dispozitat në lidhje me:

- përshtatshmërinë e ndërtesave dhe pajisjeve, të cilat duhet të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare për shëndetin dhe sigurinë, si dhe dizajnin i cili mundëson qasjen e personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë klasat, kabinetet, punëtoritë, laboratorët si dhe fushat, apo sallat sportive;
- ofrimin e bibliotekave dhe kabineteve kompjuterike;
- numrin dhe kualifikimet e stafit;
- zbatimin e KKK-së, apo të një programi të huaj, përdorimi i të cilit në Kosovë njihet nga Ministria

Një institucion privat i arsimit mund të fillojë funksionimin vetëm pasi të ketë marrë licencën për ofrimin e arsimit dhe/apo aftësimit nga Ministria, si dhe licencën e biznesit nga njëra prej komunave. Institucionet private të arsimit dhe/apo aftësimit i nënshtrohen inspektimit nga Ministria. Licenca i jep të drejtën një shkolle private, apo partneriteti publiko-privat që të ofroj programe të studimit në shkallë specifike të arsimit të përgjithshëm.

1.6 SIGURIMI I CILËSISË NË ARSIMIN E PËRGJITHSHËM

MASHT-i është përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin e përgjithshëm. MASHT-i i miraton programet dhe licencat e institucioneve, të cilat kontribuojnë në Kurrikulën Kombëtare dhe në standardet e të nxënit.

Bazuar në KKK, vlerësimi në nivel klase përfshinë vlerësimin formativ përgjatë gjithë vitit shkollor, vlerësimin përfundimtar (pas përfundimit të vitit shkollor) dhe vlerësimin përmbledhës (pas përfundimit të një nga shkallët kryesore të Kurrikulës). Vlerësimi formativ, përveç metodave të tjera jo-formale të vlerësimit gjatë gjithë procesit të mësimit përbëhet nga një shkallë e vlerësimit që përdorë sistemin e notimit nga 0 deri në 5. Vlerësimi përfundimtar ndodhë në fund të secilit vit shkollor dhe pasqyron nivelin e performancës së nxënësit gjatë tërë vitit.

Zyra për Standarde dhe Vlerësim në MASHT është përgjegjëse për përgatitjen, administrimin dhe vlerësimin e të gjitha testeve të standardizuara. Vlerësimet e standardizuara shtetërore/kombëtare organizohen pas përfundimit të klasës së 5, 9 dhe 12. Vlerësimet shtetërore/kombëtare fokusohen në matjen e nivelit të arritjes në zotërimin e kompetencave kryesore. Vlerësimi shtetëror në fund të klasës së 5 i referohet nivelit të arritjes në zotërimin e kompetencave kyçe të shprehura në Kurrikulën bërthamë përmes rezultateve të mësim-nxënies për shkallën kryesore të Kurrikulës. Vlerësimi i standardizuar në fund të klasës së 9 i referohet nivelit të arritjeve në zotërimin e kompetencave kryesore të shprehura në Kurrikulën bërthamë përmes rezultateve të mësim-nxënies për shkallën kryesore të kurrikules. Ky vlerësim përcakton kritere të qarta për nivelin e kërkuar të arritjeve në mënyrë që të kaloj në nivelin e ardhshëm arsimor, veçanërisht për shkollat e mesme të larta. Vlerësimi i standardizuar në fund të klasës së 12, përmes provimit të maturës shtetërore, ka për qëllim që të matë nivelin e arritjeve në zotërimin e kompetencave kryesore të shprehura nëpërmjet rezultateve të të nxënit për shkallë kryesore të Kurrikulës.

Sistemi për menaxhimin e informatave në arsim (SMIA) është përgjegjës për mbledhjen, hartimin dhe përpunim e statistikave të arsimit.

Për më tepër, komunat janë përgjegjëse për sigurimin e cilësisë nëpërmjet monitorimit dhe raportimit mbi menaxhimin dhe funksionimin e arsimit në komuna. Ata janë gjithashtu përgjegjës për mbikëqyrjen dhe inspektimin e procesit të arsimit në përputhje me udhëzimin e lëshuar nga MASHT-i.

Vlerësimi dhe monitorimi i jashtëm i shkollave kryhet nga Departamenti i Inspektoratit të Arsimit. Procesi i inspektimit kryhet në mënyrë që të sigurohet:

- compliance with the respective duties and functions of the institution according to the përputhshmëria me detyrat dhe funksionet përkatëse të institucioneve në përputhje me Ligjin për Arsimin Para-universitar, Ligjin për Inspektoratin e Arsimit në Kosovë dhe Udhëzimin Administrativ 11/2005 për Procedurat Administrative për inspektimin e institucioneve arsimore
- funksionimi i kënaqshëm i trupit drejtues të institucionit, Këshillat e prindërve dhe nxënësve, operacionet financiare, saktësia e regjistrave të numrit të nxënësve sipas nivelit dhe shkallës, saktësia e dokumenteve pedagogjike dhe shkollore, organizimi i klasave dhe ekzaminimet e jashtme;
- numri, kualifikimi dhe aranzhimi për zhvillimin profesional të stafit;
- mjedisi i punës përfshirë këtu përputhjen me standardet shëndetësore dhe të sigurisë së nxënësve dhe stafit, mbajtjen e të dhënave për veprimet disiplinore dhe rezultatet e tyre;
- përputhshmëria me KKK-në, përfshirë këtu Kurrikulën bërthamë dhe Kurrikulën e bazuar në shkollë, vlerësimin dhe procedurat e brendshme të ekzaminimit, si dhe përdorimin e teksteve të miratuara, burimet arsimore të mësim-nxënies dhe materialet e mësim-nxënies.

2. AAP-TË DHE SISTEMI I AFTËSIMIT TË TË RRITURVE

2.1 PËRMBLEDHJE

Parimet e sistemit arsimor promovojnë gjithëpërfshirjen e bazuar në filozofinë e mësimit gjatë-gjithë jetës dhe në cilësinë e arsimit për të gjithë. Objektivat e përgjithshme për AAP-në përfshijnë: përmirësimin e qasjes, si dhe cilësinë dhe rëndësinë e ofrimit të AAP-së për të gjithë; përmirësimin e koordinimit dhe rëndësinë për tregun e punës; forcimin e kapaciteteve institucionale dhe të menaxhimit të sistemeve të AAP-së dhe vendosjen e një baze të shëndoshë financiare për zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e saj afat-gjate, duke rritur mundësitë e aftësimit të nxënësve, të cilët e braktisin shkollimin në faza të hershme, nxënësit e shkollave të mesme të larta,ata që braktisin shkollimin, si dhe të rriturit në mënyrë që të rrisë punësimin, sidomos për femrat; dhe rritjen e perspektivës për vetë-punësim.

Ligji për AAP-në i vitit 2013 ka identifikuar fushat kryesore të aktivitetit të arsimit dhe aftësimit profesional si vijon: zhvillimin e kompetencave dhe aftësimin për punësimin e individëve në përputhje me profesionet; dhe zhvillimin e karrierave të tyre në përputhje me tregun e punës; krijimin e kulturës së përgjithshme dhe profesionale në përputhje me parimet e mësimit gjatë gjithë jetës dhe zhvillimet ekonomike, shkencore dhe teknologjike; si dhe njohjen e kompetencave të individëve bazuar në standardet profesionale të nivelit përkatës.

Ekziston një numër i ofruesve formal dhe jo-formal të AAP-së në të gjithë vendin, të cilët shtrihen nga sektori i arsimit të mesëm të lartë deri tek ofruesit e AAP-së për të rriturit, OJQ-të, ofruesit privatë dhe institucionet publike.

Shumica (rreth 60%) e nxënësve të shkollimit të mesëm të lartë janë të regjistruar në shkollat formale të AAP-së.

Vlerësohet se deri më tani janë zhvilluar 17 fusha profesionale dhe 90 profile, 60 kualifikime modulare dhe rreth 30 standarde profesionale. Deri më tani, vetëm një numër i vogël i kualifikimeve të zhvilluara janë validuar për përfshirje në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) dhe jo të gjitha standardet profesionale janë verifikuar për përdorim kombëtar (FET, 2012).

2.2 KORNIZA LIGJORE PËR AAP DHE SISTEMIN E ARSIMIT PËR TË RRITURIT

The legal framework for VET and Adult education and training is comprised of laws, administrative instructions and national strategies as follows:

Ligjet

- Ligji Nr. 04/L –032- 2011 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës
- Ligji Nr. 04/L-138 - 2013 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional
- Ligji Nr. 04-L-143 - 2013për Arsimin dhe Aftësimin për të rriturit në Republikën e Kosovës
- Ligji Nr. 03/L-060 - 2011 për Kualifikimet Kombëtare
- Ligji Nr. 2004/37 - 2004 për Inspektoratin e Arsimit në Kosovë
- Ligji Nr. 03/L-018 – 2008 për Provimin Përfundimtar dhe Provimin e Maturës Shtetërore
- Ligji Nr. 03/L-019 – 2008 për Aftësitë Profesionale, Rehabilitimin dhe Punësimin e personave me aftësi të kufizuara
- Ligji Nr. 03/L-068 – 2008 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës

Udhëzimet Administrative

- Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2009 për Themelimin e Këshillit Shtetërorë për Licencimin e Mësimdhënësve

- Udhëzimi Administrativ Nr. 01/ 2011 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë
- Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2014 për Numrin e nxënësve me module dhe kualifikime të AAP resurset infrastruktura shkollore, siguria e nxënësve
- Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2014 përKushtet dhe kriteret për veprimtarin ekonomike të institucioneve të AAP
- Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2014 për Agjencioni i arsimit dhe aftësimit profesional dhe arsimit për të rritur (AAAPARr) në Kosovë
- Udhëzimi Administrativ Nr. 7/2014 për Avancimin, autonominë dhe funksionimin e institucioneve të AAP-së
- Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2013 për Verifikimin e dokumenteve të të gjitha niveleve arsimore
- Udhëzimi Administrativ Nr. 14/2013 për Vlerësimin e performances se mësimdhënësve
- Udhëzimi Administrativ Nr. 15/2013 për Financimin e zhvillimit profesional të mësimdhënësve
- Udhëzimi Administrativ Nr. 16/2013 për Zbatimin e zhvillimit profesional të mësimdhënësve
- Udhëzimi Administrativ Nr. 17/2013 përProvimet dhe Vlerësimet
- Udhëzimi Administrativ Nr. 34/2013 përPërbërjen, funksionimin, detyrat, mandatin e përfaqësimit të Këshillit Drejtues tek institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional (AAP)
- Udhëzimi Administrativ Nr. 35/2013 për Organizimin e provimit profesional përfundimtarë
- Udhëzimi Administrativ Nr. 30/2013 për Pilotimin e Kornizës së Kurrikulës- Kurrikulës Bërthamë
- Udhëzimi Administrativ Nr. 32/2013 për Organizimin e Kurrikulës me zgjedhje në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar
- Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2012 Barasvlera dhe njohja e dokumenteve të arsimit parauniversitar te lëshuara jashtë Republikës së Kosovës
- Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2012 për Standardet e praktikës profesionale të drejtorëve të shkollave nr. 04/2012 date 02.05.2012
- Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2012 për Vlerësimin profesional të fëmijëve me nevoja të veçanta edukativo-arsimore
- Udhëzimi Administrativ Nr. 12/2011 për Organizimin e arsimit dhe aftësimit të të rriturve Nr: Data:30.12.2011
- Udhëzimi Administrativ Nr. 15/2011 për Dokumentacionin shkollor parauniversitar Nr:15/2011 Data:30.12.2011
- Udhëzimi Administrativ Nr. 16/2011 për Kalimin e nxënësit të shkollës së mesme të lartë prej një profili arsimor në tjetrin, prej një shkolle në shkollën tjetër
- Udhëzimi Administrativ Nr. 4/2009 për Zbatimin e planit dhe programit të rishikuar me plotësime për lëndët e përgjithshme të arsimit profesional për klasat 10, 11 dhe 12
- Udhëzimi Administrativ Nr. 9/2009 për Kriteret për provimin e maturës
- Udhëzimi Administrativ Nr. 5/2007 për Kushtet dhe kriteret e themelimit, licencimit dhe fillimit të punës së institucioneve të arsimit dhe aftësimit profesional
- Udhëzimi Administrativ Nr. 6/2007për Zgjerimin e aktiviteteve të shkollave profesionale

- Udhëzimi Administrativ Nr. 07/2009 për Organizimin, funksionimin dhe fushëveprimin e punës së qendrës për arsim profesional në Republikën e Kosovës (kjo është amandamentuar në vitin 2009 me UA Nr. 18/2009)
- Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2010 për Procedurat e aplikimit për njohjen e të drejtës për shkathtësitë profesionale, rehabilitimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara
- Udhëzimi Administrativ Nr. 09/2011 për Procedurat për themelimin dhe menaxhimin financiar të fondit profesional për arsim
- Udhëzimi Administrativ Nr. 31/2014 për Njohjen e mësimit paraprak
- Udhëzimi Administrativ Nr. 28/2014 Kriteret dhe procedurat për verifikimin e standardeve profesionale
- Udhëzimi Administrativ Nr. 32/2014 Për kriteret dhe procedurat për sigurimin e cilësisë në institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional – proceset e brendshme

Strategjitë Kombëtare

- Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2011-2016
- Strategjia për zhvillimin e arsimit parauniversitar në Kosovë 2007-2017
- Strategjia për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas në Kosovë 2007– 2017
- Strategjia e Aftësimit Profesional 2012-2014
- Plani Zhvillimor Strategjik 2012-2014
- Strategjia Sektoriale 2014-2020 e MPMS (e zhvilluar dhe pritet të miratohet së shpejti)

2.3 STRUKTURA E SISTEMIT TË AAP-SË

Sistemi i AAP-së përbëhet nga ofruesit formal dhe jo-formal. Ofruesit formal të AAP-së mund të ofrojnë kualifikime dhe module në nivelin 3, 4 dhe 5 të KKK-së, ndërsa ofruesit jo-formal të AAP-së mund të ofrojnë kualifikime dhe module në nivelet 2, 3, 4, dhe 5 në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare. Aktualisht, ekzistojnë kualifikimet e validuara dhe miratuara për nivelet 2, 3 dhe 4 të KKK-së, por në kuadër të KKK-së ende nuk ekzistojnë kualifikimet e validuara dhe miratuara për nivelin 5.


Ofrimi AAP-së formale përfshinë:

- Arsimin e mesëm të lartë profesional (klasën 10-12 të shkollave profesionale).
- Arsimin dhe aftësimin profesional post-sekondar (ofrimin e arsimit të bazuar në Kolegj, për ata të cilët e kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë).

Ofrimi i AAP-së jo-formale përfshinë:

- Aftësimin profesional (të lidhur me punësim dhe me punë), të ofruar në qendrat publike dhe private të aftësimit profesional, si dhe punësimin;
- Kurset e arsimit kompenzues për të rriturit që nuk kanë përfunduar arsimin fillor apo të mesëm, sipas programeve të arsimit formal, të cilat ofrohen kryesisht nga shkollat.
- Ofrimin e llojeve të ndryshme të të nxënit për të rriturit në fusha të tilla, si gjuhët të huaja, TIK, artizanale, art, muzikë dhe kulturë etj, të cilat ofrohen nga ofruesit privatë, OJQ-të, etj.

Diagrami i mëposhtëm spikat fushat kryesore të arsimit dhe aftësimit, kualifikimet dalëse në secilën fushë dhe rrugët e progresionit ndërmjet fushave.



2.4 KUALIFIKIMET, CERTIFIKIMI DHE PROGRESIONI

Në sistemin e Kosovës, kualifikimi përkufizohet si njohje zyrtare e arritjeve, i cili e njeh përfundimin e arsimimit, apo performancën e kënaqshme në një test apo provim, që çon në certifikim dhe siguron bazën për progresion në punë, apo mësim të mëtejshëm për individët.

Kualifikimet e vendosura në KKK bazuar në Përshkruesit e Nivelit (të cilët ndërlidhen me përshkruesit e EQF-së) dhe treguesit të nivelit, të cilët e përshkruajnë llojin e ofruesve formal dhe jo-formal që kryesisht çojnë në kualifikimet në kuadër të KKK-së.

Kualifikimet dalëse nga AAP-të formale janë si në vijim:

- Kualifikimi në nivelin 3 të KKK-së arrihet në një periudhë dy vjeçare, që korrespondon me klasat shkollore 10 dhe 11. Ai vlerësohet përmes provimit të brendshëm dhe i përgatit nxënësit për progresion në shkallën e ardhshme të AAP-së formale, apo për tregun e punës. Certifikimi në këtë nivel u mundëson nxënësve që të punësohen, por jo të vazhdojnë në arsimin e lartë.
- Kualifikimet në nivelin 4 të KKK-së arrihen kur nxënësit përfundojnë klasën e 12 duke e marrë një certifikatë si pjesë e vlerësimit të brendshëm. Kjo i jep të drejtën nxënësve që t`i nënshtrohen testit të maturës, i cili iu mundëson atyre avancimin në arsimin më të lartë. Të diplomuarit nuk janë të obliguar t`i nënshtrohen testit të maturës nëse dëshirojnë të hyjnë në tregun e punës, apo në AAP-të post-sekondare.
- Kualifikimi i propozuar në nivelin 5 të KKK-së është planifikuar që të arrihet për një, apo dy vjet. Ai do të përshijë një kurs profesional post-sekondar, i cili do t`i kualifikojë individët si teknikë të lartë apo specialist, anëtarë të një asociacioni të profesionistëve, apo menaxher i ri. Nxënësit e këtij niveli vlerësohen përmes provimit të brendshëm, i cili dërgon në marrjen e diplomës. Megjithatë, aktualisht në Kosovë nuk ofrohen kualifikime të tilla.

Bazuar në Ligjin për Arsimimin e të Rriturve të vitit 2012, arsimimi dhe aftësimi i të rriturve përfshinë

gjithë arsimin dhe aftësimin publik dhe privat që u ofrohet të rriturve dhe të rinjve mbi 15 vjet, të cilët janë të pranueshëm që të vazhdojnë ndjekjen e programeve arsimore të zhvilluara për ata. Bazuar në këtë ligj, arsimimi dhe aftësimi i të rriturve është pjesë përbërëse e sistemit të arsimit në Kosovë.

Gjithashtu, sipas ligjit, të nxënit formal për të rriturit bazohet në programet e arsimimit të miratuara dhe të hartuara nga MASHT-it, të cilat ofrohen nga ofruesit e licencuar të arsimit dhe aftësimit profesional. Nxënia e tillë është e strukturuar dhe shpie në certifikim. Të rriturit aplikojnë tek ofruesit e AAP-së për të vazhduar studimet e tyre në fushën e caktuar. Përmbajtja, rezultatet e të nxënit, vlerësimet dhe certifikatat e marra, janë të njëjta si për nxënësit e rregullt të AAP-së me dallimin e vetëm që është kohëzgjatja. Përderisa,nxënësit e AAP-së kalojnë 3 vite me 36 javë për vit, këto studime për të rriturit zgjasin 1.5 vite - që do të thotë 3 nga 18 javë. Këto studime për të rriturit bëhen me vetë-financim.

Kualifikimet e AAP-së jo-formale për të rriturit mund të përdorin standardet kombëtare, standardet ndërkombëtare, standardet e kërkuara nga punëdhënësit e caktuar, apo një kombinim të të dyjave. Ato mund të ofrohen nga institucionet e akredituara të AAP-së, apo qendrat për aftësim në vendin e punës. Ato mund të variojnë nga niveli 2 deri në nivelin e 7 të KKK-së si në vijim:

Niveli 2: Këto kualifikime do të përfshijnë njohuritë e përgjithshme, shkathtësitë dhe kompetencat e domosdoshme për të arritur punësimin, apo për pjesëmarrjen në jetën e përditshme. Nxënësit e synuar do të jenë të rriturit, të cilët janë të pa-punë, apo me shkathtësi bazike dhe/ose punë të rastit. Këto kualifikime do të përfshijnë njohuritë e përgjithshme, shkathtësitë dhe kompetencat e domosdoshme për të arritur punësimin, apo për pjesëmarrjen në jetën e përditshme. Nxënësit e synuar do të jenë të rriturit, të cilët janë të pa-punë, apo me shkathtësi bazike dhe/ose punë të rastit. Aktualisht, në këtë nivel të KKK-së janë të përfshira disa kualifikime, të cilat janë të validuara dhe regjistruara dhe janë disa ofrues, të cilët janë të akredituar për ofrimin e këtyre kualifikimeve.

Niveli 3: Këto do të jenë kurse të shkurtra që çojnë në kualifikime për ata që janë të punësuar, apo punëtorë gjysmë të kualifikuar. Nuk ka rregulla të veçanta rreth madhësisë së këtyre kualifikimeve. Aktualisht, ka shumë kualifikime në këtë nivel të KKK-së, të cilat janë të validuara dhe të regjistruara, si dhe ekzistojnë ofruesit e kualifikuar për të ofruar këto kualifikime.

Niveli 4: Këto janë kurse të shkurta jo-formale të bazuara në aftësi, të cilat çojnë në kualifikim të dizajnuar për të ndihmuar të punësuarit që të fitojnë aftësitë e reja për t`iu adaptuar teknologjive dhe metodave të reja të punës, të marrin përgjegjësi të reja në nivelin e njëjtë më punën aktuale që e bëjnë, apo të avancojnë në punë të nivelit më të lartë. Nxënësit, të cilët i marrin këto kualifikime zakonisht duhet të kenë njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat më të gjëra në profesion, apo fushën profesionale në nivelin 3 apo 4. Aktualisht ekzistojnë disa kualifikime në këtë nivel të KKK-së, të cilat janë të validuara dhe regjistruara dhe ofruesit janë të akredituar për ofrimin e këtyre kualifikimeve.

Niveli 5: Politika e KKK-së është që kurset/programet jo-formale në këtë nivel të çojnë në kualifikime për ata, të cilët janë të punësuar dhe duhet të mësojnë njohuri të reja, aftësi dhe/apo kompetenca më të gjera - për shembull, përdorimin e teknologjive, apo metodave, apo të marrin përgjegjësi të reja në nivelin e njëjtë me punën aktuale që e bëjnë, apo të avancojnë në punë të nivelit më të lartë. Nxënësit, të cilët i marrin këto kualifikime zakonisht duhet të kenë kualifikimet, apo përvojën në profesion, apo fushën profesionale në nivelin 4 apo 5; ato mund të jenë nga kualifikimet, apo përvoja. Aktualisht nuk ekzistojnë kualifikime në këtë nivel të KKK-së.

Niveli 6: Politika e KKK-së është që kurset të cilat çojnë në kualifikime për specialistët, profesionalistët, apo menaxherët do të vendosen në këtë nivel nëse përputhen me përshkruesit e nivelit. Këto do të jenë kurse të shkurtra, të specializuara që çojnë në kualifikimin e atyre, të cilët janë të punësuar dhe duhet të marrin njohuri të reja, shkathtësi dhe/apo kompetenca më të gjera. Këto kualifikime ka të ngjarë të njohin aplikimin e

njohurive në sajimin dhe qëndrueshmërinë e argumenteve, në zgjidhjen e problemeve dhe në sjelljen e gjykimeve, të cilat marrin parasysh çështjet sociale dhe etike. Nxënësit, të cilët i marrin këto kualifikime zakonisht duhet të kenë kualifikime, apo përvojë në profesionin, apo fushën profesionale të paktën në nivelin 4 apo 5. Aktualisht, nuk ka kualifikime në këtë nivel të KKK-së.

Niveli 7: Politika e KKK-së është që kurset, të cilat çojnë në kualifikime, të përputhen me përshkruesit e nivelit 7, i cili do të jetë për menaxherët e lartë dhe profesionalistët. Këto do të jenë kurse të shkurtra, tepër të specializuara, të cilat çojnë në kualifikime të individëve të punësuar, të cilët mbajnë një lloj përgjegjësie individuale dhe/ose përgjegjësi për të tjerët të radhitur në këtë nivel. Këto kualifikime, gjithashtu njohin aftësitë për të integruar njohuritë dhe për të bërë gjykime duke marrë parasysh çështjet sociale dhe etike, përgjegjësitë dhe / ose përvojë të menaxhimit në mjedise të ndryshime dhe komplekse. Këto kualifikime gjithashtu njohin aftësitë për të integruar njohuritë dhe për të bërë gjykime duke marrë parasysh çështjet sociale dhe etike, përgjegjësitë dhe / ose përvojë të menaxhimit në mjedise të ndryshime dhe komplekse. Aktualisht në këtë nivel të KKK-së nuk ka kualifikime.

2.5 OFRUESIT E AAP-SË

Ka një numër të ofruesve formal dhe jo-formal të AAP-së në mbarë vendin, që shtrihen nga ofruesit e sektorit të arsimit të mesëm të lartë deri tek ofruesit e arsimit për të rritur të AAP-së, OJQ-të, ofrues privatë dhe institucionet publike.

- Shkollat e arsimit profesional, publike dhe private, të cilat ofrojnë arsimim dhe aftësim formal
- Qendrat publike të Kompetencës, të cilat ofrojnë AAP fillestar dhe të avancuar për të rinjtë dhe të rriturit.
- AAP post-sekondare (kolegjet private)
- Qendrat e Trajnimit nën Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, të cilat në vazhdimësi ofrojnë AAP për punëkërkuesit e papunë
- Institucionet e tjera publike dhe private të AAP-së (përfshirë edhe vendet e punës) që ofrojnë arsim dhe aftësim jo-formal

2.6 SIGURIMI I CILËSISË NË AAP DHE ARSIM E TË RRITURVE

AKK-ja menaxhon KKK-në dhe luan një rol të madh në cilësi më të gjerë dhe qasje në sigurimin e cilësisë në sistemin kombëtar të AAP-së.

Komponentet e tjera të rëndësishme të sistemit të cilësisë përfshijnë:

- Vlerësimin e jashtëm të shkollave profesionale përmes inspekti,meve administrative dhe profesionale nga Departamenti i Inspektimit të MASHT-it;
- Sigurimin e cilësisë së Qendrave të MPMS-ës për Aftësim Profesional dhe qendrave mobile nga Divizioni i AAP-së në MPMS;
- Vlerësimin e brendshëm të shkollave nëpërmjet praktikës më të re, atë të vetëvlerësimit;
- Testet e jashtme dhe provimet, sidomos të maturës dhe testet e standardizuara pas Vitit 9;
- Rolin e Sigurimit të cilësisë së Zyrës për Standarde dhe Vlerësim në MASHT;
- Rolin e komunave sipas Ligjit për AAP në ‘mbikëqyrjen dhe inspektimin e procesit arsimor në pajtim me Udhëzimet e përcaktuara nga MASHT-i,” dhe në fusha të tjera që ndikojnë në cilësinë e ofrimit të AAP-së;
- Përfshirjen e partnerëve social dhe palëve të interesuara nëpërmjet KAAP-së për

zhvillimin e standardeve të profesionit (KAAP-ja rekomandon miratimin e programeve dhe standardeve të profesionit)

AKK-ja është përgjegjëse për të siguruar që proceset për sigurimin e cilësisë, ekzistojnë, me qëllim të ruajtjes së cilësisë së kualifikimeve të regjistruara në kornizë dhe që u jepen nxënësve nëpërmjet:

- Sigurimit të cilësisë gjatë ofrimit, vlerësimit dhe dhënies së kualifikimeve të vlefshme dhe të miratuara brenda kornizës;
- Sigurimit të cilësisë nga institucionet e akredituara për dhënien e tyre; dhe
- Verifikimit të standardeve të profesionit

Disa kualifikime tashmë janë inkorporuar në Kornizë dhe një numër i ofruesve janë akreditуar.

Për më tepër, AKK-ja mbështet ofruesit e AAP-së për përgatitjen e raporteve të vetëvlerësimit dhe publikon një sërë udhëzimesh mbi tema të tilla si kryerja e vetëvlerësimit, zhvillimi i standardeve të profesionit dhe zhvillimi i kualifikimeve, gjithashtu do të sigurojnë që KKK-ja realizohet për të mbështetur përmirësimin e cilësisë në AAP. AKK-ja është përgjegjës për akreditimin e ofruesve të AAP-së dhe arsimit për të rriturit, për validimin e kualifikimeve dhe verifikimin e standardeve të profesionit.

Kriteret kryesore që janë aplikuar për akreditimin e ofruesve të AAP-së përfshijnë të pasurit: e një qasjeje efektive të certifikimit; politikave dhe praktikave të përshtatshme për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta; sistemeve adekuate për njohjen e kredive të arritura nga kandidatët dhe mundësimi i transferimit të tyre; kapaciteteve për të përmbushur kërkesat specifike për kualifikim; dhe sistemin e dokumentacionit dhe regjistrit për të garantuar sigurimin e cilësisë.

Detyrimi ligjor për shkollat e AAP-së është organizimi i një procesi të vetëvlerësimit dhe publikimi i raporteve vjetore të vetëvlerësimit, si një hap i rëndësishëm në përmirësimin e standardeve kombëtare të cilësisë në AAP. AKK-ja komenton mbi këto raporte dhe gjithashtu ofron rekomandime për përmirësime.

Në nivel shkolle janë të pranishëm mekanizmat e mëposhtme të sigurimit të cilësisë, të tilla si: grupe profesionale pune; komisione për çdo nivel; Komisioni i mësimdhënësve; të gjitha shkollat kanë nga një koordinator të sigurimit të cilësisë. Koordinatorët e sigurimit të cilësisë janë përgjegjës për sigurimin e cilësisë brenda qendrës dhe gjithashtu veprojnë si persona udhëheqës në përgatitjen dhe koordinimin e përgatitjes së raportit të vetëvlerësimit, si dhe të reagojnë në bazë të rekomandimeve të dhëna nga AKK-ja në raportin e vetëvlerësimit.

Sipas Udhëzimit Administrativ për inspektorët e arsimit, detyrat kryesore të inspektorëve të arsimit, ndër të tjera, janë edhe, inspektimi: i kushteve të procesit të arsimit (inventarit, mjetet e arsimit, mjediset, etj) të cilat janë të përcaktuara në programin e punës; realizimit të programit vjetor të punës së institucionit; funksionimit të organeve udhëheqëse dhe profesionale dhe institucioneve arsimore; realizimit të programit mësimor dhe kushtet e realizimit; monitorimit të orëve mësimore; organizimit të arsimit jo-formal. Megjithatë, nga diskutimet në seminar u theksua se për shkak të numrit të vogël të inspektorëve vetëm disa prej këtyre qëllimeve janë arritur.

3. SISTEMI I ARSIMIT TË LARTË NË KOSOVË

3.1 PASQYRA E SISTEMIT TË ARSIMIT TË LARTË NË KOSOVË

Sipas Ligjit Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë, arsimi i lartë në Kosovë mund të ofrohet nga institucionet publike ose private. Emërtimet e institucioneve të arsimit të lartë janë të rregulluara me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe UA nr. 01/2013 për emërtimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë. Ato përfshijnë: universitetet, universitetet aplikative, kolegje universitare, kolegjet, akademitë, shkolla te larta

profesionale dhe shkolla te larta teknike. Universitete dhe kolegjet universitare[1] janë institucione që ofrojnë arsim dhe kërkim shkencor, dhe ofrojnë programe studimi në të tre ciklet e arsimit të lartë (Bachelor, Master dhe Doktoratë). Këto dy lloje të institucioneve dallojnë në aspektin e shumëllojshmërisë së programeve të tyre të studimit: Universitetet ofrojnë programe në të paktën pesë fusha lëndore të Erasmus, ndërsa kolegjet universitare ofrojnë programe në të paktën tri fusha të tilla. Kolegjet dallojnë nga universitetet dhe kolegjet universitare në atë se, ato nuk ofrojnë arsim të lartë në nivelin e tretë (doktoratë) dhe natyra e hulumtimit që ata e kryejnë është aplikative. Akademitë dhe shkollat e larta profesionale ofrojnë studime profesionale dhe mund të ofrojnë hulumtim aplikativ, kurse dallimi në mes të dyve është se kjo e para përqendrohet në një lëndë specifike (p.sh. në fusha specifike të artit, sportit, rendit publik, të sigurisë dhe fusha të tjera profesionale).

Sistemi i arsimit të lartë në Kosovë përfshin arsimin e lartë akademik dhe arsimin e lartë profesional, edhe pse në legjislacionin aktual nuk ka dallim të qartë ndërmjet tyre. Në arsimin e lartë akademik dhe profesional, të dyja e kanë Nivelin Bachelor dhe atë Master. Në përputhje me Kornizën e Bolonjës dhe Ligjin nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë, arsimi i lartë është zakonisht i organizuar në tri nivele kryesore që çojnë në kualifikime në bachelor, master dhe doktoratë, dhe kjo përfshin çdo arsim tjetër post-sekondar në nivelet 5-8 të KKK-së, për të cilat mund të jepen ECTS kredi. Kualifikimet e arsimit të lartë mund të lëshohen nga institucionet e arsimit të lartë,të cilat janë të akredituara nga Agjencia e Akreditimit të Kosovës (AAK) dhe të licencuara nga MASHT-i që të ofrojnë programe të arsimit të lartë.

3.2 KORNIZA LIGJORE

Korniza ligjore për arsimin e lartë përbëhet nga ligjet, udhëzimet administrative dhe strategjitë kombëtare si më poshtë:

Ligjet

- Ligji nr. 04/L-037-2011 për Arsimin e Lartë në Kosovë

Udhëzimet Administrative

- Udhëzimi Administrativ Nr. 14/2003 mbi Licencimin e Ofruesve Privatë të Arsimit të Lartë në Kosovë
- Udhëzimi Administrativ Nr. 11/2004 Themelimi i Agjencisë së Akreditimit të Kosovës
- Udhëzimi Administrativ Nr. 14/2008 për Implementimin e ECTS në Arsimin e Lartë në Kosovë
- Udhëzimi Administrativ Nr. 2/2009, UA Nr. 25/2012 dhe UA Nr. 02/2013 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë
- Udhëzimi Administrativ Nr. 12/2009 për Kriteret dhe procedurat për akreditimin e shkollave të larta profesionale dhe teknike
- Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2012 për Caktimin e formës dhe përmbajtjes së diplomave dhe shtojcave të diplomave të ofruesve të arsimit të lartë.
- Udhëzimi Administrativ Nr. 23/2012 për Gradat dhe diplomat e ofruesve të arsimit të lartë.
- Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2013 për Emërimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë.

Strategjitë kombëtare

- Strategjia për Zhvillimin e Arsimit të Lartë në Kosovë (2005-2015)
- Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë (2001-2016)

1) *Universitetet ofrojnë studime në të paktën pesë fusha akademike, ndërsa kolegjet universitare ofrojnë studime të paktën tri fusha akademike.*

3.3 STRUKTURA E PROGRAMEVE TË ARSIMIT TË LARTË

Siç u theksua më lartë, institucionet e arsimit të lartë në Kosovë organizojnë studime sipas strukturës tre cikëlshe të Bolonjës dhe zbatojnë sistemin e ECTS kredive në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-037 mbi Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës dhe UA nr. 14/2008 për implementimin e ECTS në Arsimin e Lartë në Kosovë. Sipas këtij ligji, arsimi i lartë është i organizuar si më poshtë:

- Cikli i parë: Programe Bachelor
- Cikli i dytë: Programe Master.
- Cikli i tretë: Programe të studimeve të Doktoratës me karakter akademik dhe të pavarur kërkimor-shkencor.

Edhe pse përqindja e kredive të marra përmes moduleve të detyrueshme dhe zgjedhore brenda një studimi nuk është përcaktuar në mënyrë rigoroze, pjesët e detyrueshme ka tendencë që të llogarisin 70 për qind të ECTS kredive, ndërsa ato zgjedhore 30 për qind.

Është e detyrueshme të punohet nga një tezë për të dy Programet Bachelor dhe Master. Numri i ECTS kredive i caktuar për tezën e Bachelor vendoset nga ana e institucioneve të arsimit të lartë, ndërsa numri i ECTS kredive të një teze të Masterit është 30.

Studimet e doktoratës zakonisht organizohen përmes një kombinimi të provimeve dhe një teme të doktoratës, e cila prezantohet dhe mbrohet publikisht. Këto studime zgjasin të paktën tre vjet dhe ofrohen aktualisht vetëm në arsimin e lartë akademik.

Sistemi arsimor i Kosovës dominohet nga institucionet e arsimit të lartë akademik dhe programet studimore akademike. Aktualisht, programet akademike ofrohen për nivelet 6-8 të KKK-së, ndërsa programet profesionale ofrohen për nivelet 6-7 të KKK-së. KKK-ja parasheh ofrimin e arsimit të lartë profesional për nivelet 5-7 të KKK-së. Megjithatë, ofrimi i nivelit 5 të KKK-së është në një fazë relativisht të hershme të zhvillimit. Edhe pse programet e shkurtra arsimore tre-cikëlshe të Bolonjës janë të parapara në nivelin 5 të KKK-së, aktualisht nuk ofrohen programe të tilla dhe titulli për këto kualifikime nuk dihet ende.

Arsimi i lartë profesional mund të ofrohet nga ofruesit publikë dhe privatë të akreditуar nga AAK-ja. Mund të ofrohet nga institucionet e arsimit të lartë që ofrojnë arsim të lartë akademik, apo institucione që veçanërisht fokusohen në arsimin profesional akademik, shkollat e larta profesionale, apo shkollat e larta teknike.

3.4 KUALIFIKIMET, CERTIFIKIMI DHE PROGRESIONI

Studentët e regjistruar në sistemin formal të arsimit kanë tendencë të ndjekin një progres linear nga një nivel arsimor (ose kualifikim) në një tjetër. Përfundimi i çdo kualifikimi në një nivel të caktuar lejon pranimin në programet që çojnë në kualifikime në nivelin e ardhshëm.

Për t'u pranuar në një program të arsimit të lartë, studenti duhet të posedoj kualifikimin e mesëm të lartë të nivelit të arsimit, diplomën e maturës shtetërore, dhe kjo vlen për të gjitha institucionet e arsimit të lartë dhe të dy programet akademike dhe profesionale. Ligji Nr. 03/L-018 për Provimin Përfundimtar dhe Provimin e Maturës Shtetërore obligon të gjitha institucionet e arsimit të lartë të pranojnë rezultatet që nxënësit kanë arritur si gjatë shkollimit të mesëm, në vlerësimet e brendshme ashtu edhe në provimin e jashtëm të standardizuar të maturës shtetërore[2]. Sidoqoftë, institucionet publike të arsimit të lartë me një miratim nga MASHT-i mund të organizojnë testet shtesë të pranimit, sipas kërkesave të tyre për regjistrim të përcaktuara në Statutet e tyre.

Progresioni i programeve të studimit që çojnë nga niveli 5 i programeve të kualifikimeve në KKK tek Niveli 6 në KKK, është parashikuar nga KKK-ja. Aktualisht, megjithatë, nuk ka legjislacion primar apo

2) *Diploma e maturës shtetërore fitohet pas provimit të maturës në fund të gjimnazit tre vitesh apo katër vite të arsimit profesional. Studentët e programeve profesionale të arsimit të mesëm mund të zgjedhin të mos hyjnë në testin e Maturës Shtetërore, por ata duhet të arrijnë këtë kualifikim në qoftë se dëshirojnë të vijojnë ndonjë program të arsimit të lartë.*

sekondar që rregullon këtë lloj progresioni.

Në Nivelet 6, 7 dhe 8, të KKK-së kualifikimet dalëse të arsimit të lartë përcaktohen nga korniza e Bolonjës dhe ato kanë tituj të përgjithshëm: Bachelor, Master dhe Doktoratë [3].

Sipas UA nr. 23/2012 mbi Gradat dhe diplomat e Arsimit të Lartë, dokumentet e mëposhtme të arsimit të lartë dëshmojnë përfundimin e programeve studimore të arsimit të lartë:

- Një Diplomë Bachelor jepet nga çdo ofrues i akreditуar dhe licencuar i arsimit të lartë, i cili ofron programe studimore të ciklit të parë me një kohëzgjatje prej 3 deri në 4 vjet dhe 180-240 pikë të ECTS kredive.
- Një Diplomë Master jepet nga çdo ofrues i akreditуar dhe licencuar i arsimit të lartë, i cili ofron programe studimore të ciklit të dytë me një kohëzgjatje prej 1 deri në 2 vjet dhe 60-120 pikë të ECTS kredive, me kusht që shuma e përgjithshme e pikave të kredive për të dy nivelet e studimit (Bachelor dhe Master) të jetë 300 pikë të ECTS kredive.
- Një Diplomë e Doktoratës lëshohet nga çdo ofrues i akreditуar dhe licencuar i arsimit të lartë, i cili ofron programe studimore të ciklit të tretë, të cilat janë të një natyre akademike kërkimore- shkencore,dhe që zgjasin të paktën 3 vite.

Diplomat e mësipërme janë aktualisht të përgjithshme për të gjitha programet në këto nivele, si programe akademike dhe profesionale, kurse titulli specifik i diplomave të Bachelor, Master dhe Doktoratës përcaktohet në përputhje me Rregulloren e vet institucioneve të arsimit të lartë për dhënien e diplomave dhe certifikatave.

Pas përfundimit me sukses të programit studimor, të gjitha institucionet e arsimit të lartë në Kosovë janë të obliguara me Ligjin Nr 04/L-037 për Arsimin e Lartë t`u japin studentëve një Diplomë dhe një shtojcë të mbyllur të diplomës, me formën dhe përmbajtjen, e cila përcaktohet nga UA Nr. 02/2012 për Formën dhe përmbajtjen e Diplomave dhe shtojcave të diplomës të ofruesve të Arsimit të Lartë.

Përveç informacionit mbi studentin dhe programin studimor, i cili është përfunduar, diploma duhet të specifikojë numrin e ECTS kredive të fituara dhe nivelin e kualifikimit në KKK. Udhëzimi Administrativ, gjithashtu përcakton modelin e shtojcës së diplomës në përputhje me Konventën për Njohjen e Kualifikimeve lidhur me Arsimin e Lartë në Rajonin Evropian (Konventa e Lisbonës 1997). Një mostër e shtojcës së diplomës është dhënë në Shtojcën 2.

3.5 OFRUESIT E ARSIMIT TË LARTË

Ofruesit e mëposhtme ofrojnë arsim të lartë akademik dhe profesional në Kosovë:

- Shtat (7) universitete publike:
  - Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”
  - Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”
  - Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka”
  - Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka”
  - Universiteti i Gjakovës “FehmiAgani”
  - Universiteti i Mitrovicës (Isa Boletini) dhe
  - Universiteti i Mitrovicë (Veri)
- Njëzet e katër (24) institucione private të arsimit të lartë, nga të cilat:
  - Njëzet e një (21) kolegje
  - Dy shkolla (2) të larta profesionale
  - Një (1) akademi

3) Rregullat për emërtimin ekurseve të ciklit të shkurtër të Bolonjës nuk janë vendosur deri më sot.

Cikli dy dhe tre i programeve të arsimit të lartë ofrohet edhe nga degët e universiteteve të huaja, ose nga institucionet lokale sipas licencës, franshizës apo marrëveshjeve me universitete të huaja për shërbim, programet e të cilave janë validuar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim:

- Fakulteti i Ekonomisë - Universiteti i Lubjanës (MBA)
- Staffordshire University programmes në kolegjin Riinvest (BA dhe MBA)
- Shkolla e Biznesit EADA (MBA)

3.6 SIGURIMI I CILËSISË

MASHT-i është përgjegjës për planifikimin e zhvillimit të arsimit të lartë në Kosovë. MASHT-i është gjithashtu përgjegjës për licencimin e institucioneve të arsimit të lartë[4], ndërsa AAK-ja është institucioni që kryen vlerësimin e jashtëm të cilësisë. AKK-ja është përgjegjës për zhvillimin strategjik dhe mirëmbajtjen e KKK-së duke përfshirë të gjitha llojet e kualifikimeve, duke përfshirë nivelet 6, 7 dhe 8. MASHT-i, përmes Qendrës Kombëtare për njohje dhe informim akademik (NARIC), e themeluar në vitin 2008, është përgjegjëse për zhvillimin e politikave dhe praktikave për njohjen e kualifikimeve të fituara jashtë shtetit dhe dhënien e këshillave dhe informacioneve në lidhje me njohjen akademike të diplomave të lëshuara në vende të tjera. Vendimet për njohjen e kualifikimeve të fituara jashtë vendit bëhen nga Këshilli Kombëtar për Njohje,i cili përbëhet nga shtatë anëtarë: një udhëheqës/përfaqësues nga zyra NARIC dhe gjashtë ekspertë të brendshëm (p.sh. MASHT-i), si dhe ekspert të jashtëm me përvojë relevante në arsimin e lartë ndërkombëtar dhe procesin e Bolonjës. Në vitin 2008 MASHT-i ka themeluar edhe Këshillin Shtetëror të Arsimit të Lartë, një këshill ekspertësh me një rol këshillues, i cili ofron këshilla për reformat arsimore në arsimin e lartë.

Në bazë të Ligjit për Arsimin e Lartë, përgjegjësitë e Agjencisë e Kosovës për Akreditim përfshijnë: (a) këshillimin me Ministrinë lidhur me kërkesat e institucioneve për licencimin e kurseve apo programeve të tyre, të cilat janë pjesë e një kualifikimi, apo që shpien në fitimin e kualifikimeve të arsimit të lartë; (b) inspektimin e ofruesve të arsimit të lartë dhe këshillimin me Ministrinë lidhur me dhënien, ndryshimin ose anulimin e licencave; (c) kryerjen e kontrolleve periodike mbi cilësinë e ofruesve të licencuar të arsimit të lartë dhe marrjen e vendimit për akreditimin apo ri-akreditimin e tyre, duke përfshirë të drejtën për dhënien e titujve dhe diplomave; (d) kryerjen e vlerësimeve periodike të cilësisë së programeve të ofruara nga ofruesit e akredituar të arsimit të lartë; (e) këshillimin e Ministrisë lidhur me rezultatet e vlerësimit të cilësisë dhe implikimet e tij për financimin e ofruesve publik të arsimit të lartë, lidhur me caktimin e fondeve për ofruesit privatë të arsimit të lartë dhe me mbështetjen sipas gjykimit të lirë për studentët që ndjekin programe studimi tek ofruesit privatë të arsimit të lartë dhe (f) kryerjen, në emër të Ministrisë, të atyre funksioneve që mund të delegohen lidhur me njohjen e kualifikimeve akademike dhe profesionale. Sipas këtij ligji, AKA-ja obligohet të publikojë konkluzionet, rekomandimet dhe këshillat.

AKA-ja përbëhet nga një organ profesional dhe një organ administrativ. Këshilli Kombëtar i Cilësisë (KKC) është organ qeverisës, i cili ka përgjegjësinë e përgjithshme për funksionimin e AKA-së. Ndër përgjegjësitë kryesore të KKC-së janë: (a) përcaktimi i objektivave të procesit të vlerësimit të institucioneve të arsimit të lartë, (b) miratimi i procedurave dhe kritereve të vlerësimit të jashtëm, të hartuara nga AKA-ja, (c) krijimi i grupeve profesionale të vlerësimit të Institucioneve të Arsimit të lartë (IAL), (d) marrja e vendimeve për akreditimin bazuar në raportet e ekipeve profesionale të vlerësimit.

Funksionet e Organit Administrativ- AKA së, janë: (a) të përcaktojë standardet dhe procedurat e akreditimit, (b) të lëshojë rekomandime për IAL-të, të cilat aplikojnë për akreditim të institucionit, ose të programit dhe (c) t'i jap rekomandime MASHT-it për licencimin e IAL[5]-ve.

AKA-ja është bërë gjithashtu një anëtare e plotë e Asociacionit Evropian për Sigurimin e Cilësisë për Arsimin e Lartë ENQA.

---

4) Licencimi i institucioneve private të arsimit të lartë është i rregulluar me UA Nr. 14/2003 mbi Licencimin e bartësve privatë të arsimit të lartë në Kosovë

5) Kriteret dhe procedurat e akreditimit janë të publikuara ne uebfaqen e AAK (www.akreditimi-ks.org). Të gjitha kriteret e akreditimit janë të paraqitura në Aneksin 4.

4. KORNIZA KOMBËTARE E KUALIFIKIMEVE TË KOSOVËS (KKK)

4.1 ZHVILLIMI I KKK-SË

Korniza Kombëtare e Kualifikimeve të Kosovës është themeluar nga AKK-ja me ndihmën e projekteve të EU-KOSVET III dhe V. Pas testimit në terren, KKK-ja u rishikua dhe versioni final ka përfunduar në vitin 2011. Korniza është miratuar nga Këshilli Drejtues i AKK-së.

KKK-ja është zhvilluar me angazhimin e një sërë akterëve, duke përfshirë MASHT-in, MPMS-në, Ministritë e tjera me interes të drejtpërdrejtë në kualifikime (sidomos ajo e Shëndetësisë, Tregtisë dhe Industrisë, Kulturës,Rinisë dhe Sportit), AKK-së, Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), sindikatat, shkollat profesionale, qendrat e aftësimit dhe ofruesit e ndryshme jo-formal të AAP-së.

Punën në këtë drejtim e mbështetën disa ekspertë ndërkombëtar, ku disa prej tyre ishin nga Britania e Madhe, të cilët sollën përvojën e tyre profesionale, si të zhvillimit ashtu edhe të zbatimit të KKK-së.

Procesi kaloi nëpër fazat si në vijim:

- Në vitin 2004 Seminari i parë u mbajt në Kosovë, ku pjesëmarrësit ishin nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Seminari është organizuar dhe mbështetur nga Fondacioni Evropian i Trajnimit (ETF) dhe pjesëmarrësit janë informuar se Komisioni Evropian është në një proces të zhvillimit të Kornizë Evropiane te Kualifikimeve (KEK). Në këtë seminar Autoritetet e Kosovës dhe akterët relevant shprehën angazhimin e tyre për t'u bërë pjesë e procesit me qëllim të zhvillimit të një KKK-je në përputhje me KEK.
- Në vitin 2005 grupi punues nga Kosova zhvilloi një vizitë studimore në Irlandë. Ky vend ishte zgjedhur duke pasur parasysh faktin se ka një KKK të shume te zhvilluar. Grupi punues, i quajtur grupi i Dublinit, që bëri këtë vizitë ishte i përbërë nga përfaqësues të MASHT-it, MPMS-së, OEK; Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës, dy anëtarë të Komisionit për Arsim nga Kuvendi i Kosovës dhe një përfaqësues nga shoqëria civile.
- Duke marrë parasysh se KKK-ja e Irlandës kishte një bazë ligjore, pas kthimit nga Irlanda, grupi i Dublinit ka nisur diskutimet mbi nevojën për të zhvilluar ligjin për KKK-në, i cili gjithashtu do të parashihte themelimin e AKK-së. Në vitin 2005 është zhvilluar drafti i parë i KKK-së.
- Në vitin 2006 gjatë një punëtorie 5 ditore, një grup i madh pune filloi hartimin e Ligjit për KKK-në. Procesi zgjati për 2 vjet me ç`rast ishin të angazhuar rreth 15 anëtarë dhe ekspertë. Në vitin 2008, Ligji u dërgua në parlament për miratim.
- Një punëtori u mbajt në tetor të vitit 2007 për tu shqyrtuar propozimet, dhe janë dakorduar se ekziston nevoja për krijimin e një Task Force në AKK, e cila mund të veprojë si një AKK në hije, dhe një Grup Pune për KKK-në, i cili mund të projektonte KKK-në. Këto organe janë themeluar në prill të vitit 2008 dhe janë takuar çdo muaj për të avancuar këtë punë.
- Një Grup Punues për KKK është themeluar nga MASHT-i në vitin 2008 për të marrë përgjegjësinë për hartimin e KKK-së. Ai përbëhej nga përfaqësues nga MASHT, MPMS, shkollat e AAP, universitetet, ofruesit jo-formal të aftësimit, qendrat e aftësimit në institucionet publike dhe shoqëria civile. Ky Grup Punues ka punuar në: numrin e niveleve në KKK dhe çfarë ato nënkuptojnë; një sistem të sektorëve profesionale për përdorim në KKK; procesin e nivelimit; dhe përcaktimin e një sistemi të kredive.
- Në të njëjtën kohë, një Task Force në AKK u krijua për të elaboruar detyrat e AKK-së. Ky Grup Punues ka punuar në atë se: si të vendosë se cilat kualifikime duhet të përfshihen në KKK; se si të vendosin se cilave institucione duhet lejuar që të vlerësojnë nxënësit dhe lëshojnë certifikata, si dhe atë se çfarë sigurimi i cilësisë duhet të zbatohet për proceset e vlerësimit dhe certifikimit.
- Një punëtori për përhapje e mbajtur në dhjetor të vitit 2008, e cila përcolli të arriturat e

Grupit Punues të AKK-së dhe Grupit Punues për KKK-në për një grup të gjerë të palëve të interesuara. Pas punëtorisë, draft politikat e AKK-së, procedurat dhe kriteret e zhvilluara nga Task Forca e AKK-së dhe Grupi Punues për KKK-në u finalizuan dhe u hartua një draft plan operativ për AKK-në që përmban një draft-plan për zbatimin e KKK-së.

- Draft Ligji për Kualifikimet është finalizuar në muajin korrik të vitit 2008 dhe u miratua nga Kuvendi i Kosovës në nëntor të vitit 2008.
- Në vitin 2011 u organizua një konferencë kombëtare për të lancuar KKK-në e miratuar.

Një nga rolet e KKK-së është mbështetja e përfshirjes së personave me nevoja të veçanta përmes një sërë masash, të cilat janë shpjeguar në dokumentin "Udhëzime mbi modifikimet dhe përshtatjet e nevojshme për zhvillimin e qasjes në programet e arsimit dhe aftësimit profesional dhe kualifikimeve për nxënësit me aftësi të kufizuara, apo me nevoja të tjera të veçanta "(AKK, 2011). Ky dokument përfshin gjithashtu një sërë mjetesh për ndryshime në mësimdhënie, mësim-nxënie dhe vlerësim për t`i akomoduar nxënësit me aftësi të kufizuara, apo me nevoja të tjera të veçanta.

4.2 AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE (AKK)

AKK-ja është themeluar në vitin 2008 në bazë të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare. Sipas ligjit, AKK-ja është organ i pavarur publik i krijuar me mbështetjen e MASHT-it që vepron në marrëveshje me Zyrën e Kryeministrit dhe Ministritë tjera relevante, si dhe partnerët social. AKK-ja e ka Këshillin Drejtues, që përbëhet prej 13 anëtarëve, të cilët përfaqësojnë: MASHT-in; MPMS-në; Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë; Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave; Ministritë e tjera përkatëse; Universitetet; Organizatat e partnerëve social; OJQ-të arsimore dhe aftësuese; ofruesit privat të arsimit dhe aftësimit; nxënësit me nevoja të veçanta. Përveç kësaj, AKK-ja themelon Këshillat dhe Grupet Punuese, sipas nevojës, për të këshilluar dhe kryer aktivitetet e ekspertëve për mbështetjen e ushtrimit të funksioneve të saj. Funksionet e AKK-së përfshijnë zhvillimin e politikës dhe strategjisë për krijimin dhe zbatimin e Sistemit Kombëtar të Kualifikimeve.

Ligji për Kualifikimet Kombëtare qartëson se aspektet e përgjegjësive të AKK-së do të ndahen me institucionet e tjera.

Përgjegjësia operative për KKK-në ndahet ndërmjet tri organeve të autorizuara:

- AKK-ja për kualifikimet e arsimit dhe aftësimit profesional;
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për kualifikimet e arsimit të përgjithshëm;
- Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) për kualifikimet e arsimit të lartë.

Në KKK, këto tre organe punojnë me parime, praktika dhe kritere të përbashkëta për funksionet kryesore të KKK-së: validimin e kualifikimeve; akreditimin e institucioneve për ofrimin e këtyre kualifikimeve; vlerësimin dhe certifikimin e sigurimit të cilësisë. AKK-ja, AKA-ja dhe MASHT-i kanë përgjegjësi të veçanta për llojet e caktuara të kualifikimit. Është një parim i rëndësishëm i menaxhimit të KKK-së që këto përgjegjësi janë të përcaktuara nga lloji i kualifikimit, dhe jo nga niveli i kualifikimit. Përgjegjësitë operative në lidhje me rregulloren e kualifikimeve në KKK janë të ndara në ato që merren me sigurimin e cilësisë dhe ato të cilat janë më administrative.

Struktura menaxhuese e AKK-së është e prezantuar në diagramin e mëposhtëm:



Funksionet e AKK-së lidhur me KKK-në janë: hartimi i KKK-së, duke caktuar nivelet e kornizës, llojet dhe nivelet e certifikatave dhe diplomave që do përfshihen në proces me synim të lehtësimit të progresionit dhe transferimit përmes mënyrave të ndryshme të mësimit dhe sigurimin e pajtueshmërisë me KEK; krijimi i kritereve dhe proceseve për aprovimin e kualifikimeve të propozuara për përfshirje në KKK; miratimi i kualifikimeve që do të përfshihen në nivelet e caktuara të Kornizës dhe ri-miratimi i tyre sipas nevojës.

AKK-ja kryen funksionet në lidhje me dhënien e kualifikimeve. Këto funksione përfshijnë: miratimin (dhe, sipas nevojës, ri-miratimin) aranzhime te standardeve, vlerësimeve dhe certifikimit për çdo kualifikim në KKK; akreditimin, rregullimin dhe monitorimin e institucioneve të vlerësimit dhe institucioneve që kryejnë funksione tjera në emër të AKK-së, për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat për çdo kualifikim të aprovuar; sigurimin e jashtëm të cilësisë së vlerësimeve, që çon tek dhënia e kualifikimeve në KKK; mirëmbajtjen e bazës së të dhënave dhe evidencave të verifikuara dokumentuese të kualifikimeve në KKK dhe të certifikatave dhe diplomave të dhëna; shqyrtimin e ankesave të kandidatëve lidhur me vendimet e diskutueshme të vlerësimit nga qendrat për vlerësim dhe organet që kryejnë funksione tjera në emër të AKK; rishikimet periodike të vlerësimit dhe krahasimet ndërkombëtare të kualifikimeve; këshillimin e institucioneve përgjegjëse për njohjen e kualifikimeve të huaja, për qëllime akademike ose punësimi, mbi çështjet e krahasueshmërisë dhe/apo barasvlerës.

4.3 KORNIZA KOMBËTARE E KUALIFIKIMEVE

Siç përcaktohet nga Ligji për Kualifikimet, Korniza Kombëtare e Kualifikimeve (KKK) synon:

- përmirësimin e qasjes në punë dhe mësimin e mëtejshëm, duke siguruar se kualifikimet janë relevante për punësim, nxënie, si dhe përmbushin nevojat e nxënësve, ekonomisë dhe institucioneve të arsimit dhe aftësimit;
- mbështetjen e përmirësimeve në cilësinë dhe rëndësinë e arsimit dhe aftësimit, duke nxitur zhvillimin e kualifikimeve, të cilat janë të bazuara në standardet e njohurive, shkathtësive dhe kompetencave të krahasueshme me nivelin ndërkombëtar, dhe të mbështetura në sigurimin rigoroz të cilësisë;

- sigurimin e transparencës më të madhe në kuadër të sistemit kombëtar të kualifikimeve, qartësimin e natyrës së kualifikimeve dhe marrëdhënien ndërmjet kualifikimeve, si dhe sigurimin e një baze për krahasimin e të arriturave në të gjitha pjesët e sistemit të arsimit dhe aftësimit;
- mbështetjen e progresionit dhe mobilitetit më të madh për mësimin gjatë gjithë jetës përmes skemave të arsimit dhe aftësimit;
- mundësimin e të mësuarit fleksibël dhe të individualizuar, si dhe të punësimit nëpërmjet rritjes së qasjes në vlerësim dhe certifikim, si dhe njohjes dhe certifikimit më të madh të nxënit dhe të të arriturave;
- ofrimin e bazës për bashkëpunim dhe njohje reciproke të kualifikimeve ndërmjet KKK dhe EQF.

Kualifikimet në KKK mund të ofrohen vetëm nga institucionet e akredituara. Nxënia që çon në këto kualifikime mund të zhvillohet në kontekste formale, jo-formale dhe informale dhe në institucione të ndryshme, të tilla si: shkollat e përgjithshme dhe profesionale, qendrat e aftësimit profesional, ndërmarrjet, ofruesit privat të arsimit dhe aftësimit, institucionet profesionale post-sekondare dhe institucionet e arsimit të lartë.

Secili kualifikim në KKK do të shpie në një certifikatë, apo diplomë.

Korniza përbëhet nga tetë nivele, në të cilat mund të vendosen kualifikimet dhe modulet, apo komponentët e tjera të kualifikimeve. Secili nivel i KKK-së definohet nga një deklaratë e rezultateve e të nxënit, bazuar në qasjen e miratuar nga KEK. Përshkruesit në Korniza definohen nga rezultatet tipike, si në vijim: **Njohuri**- përfshirë teorike dhe/ose praktike; **Shkathtësi**- të cilat mund të jenë njohëse, krijuese ose praktike; dhe **Kompetencat më të gjëra**-në autonomi dhe përgjegjësi.

Përshkruesit e nivelit të KKK-së në Kosovë bazohen në përshkruesit e nivelit të KEK. Nivelet 1-8 në KKK korrespondojnë me nivelet 1-8 të KEK.

Aktualisht ka 5 lloje të specifikuara të kualifikimeve të njohura në KKK:

A. Kualifikimet e Arsimit të Lartë
B. Kualifikimet e Arsimit të Përgjithshëm
C. Kualifikimet që kombinojnë arsimin e përgjithshëm dhe profesional
D. Kualifikimet e bazuara në shkathtësi të bazuara në standardet e miratuara kombëtare
E. Kualifikimet e bazuara në shkathtësi, të cilat nuk janë të bazuara në standardet kombëtare.

AKK-ja planifikon të shqyrtojë dhe përditësojë këto përkufizime në pjesën e dytë të vitit 2014.

Tabela: Nivelet e KKK-së lidhur me fazat e përzgjedhura të mësimit gjatë gjithë jetës në kontekst të strukturave dhe legjislacionit arsimor

Korniza e Kualifikimeve Kombëtare				
Niveli i KKK-së	**Përmban kualifikime të shoqëruara me**			**Niveli referues i KEK**
	Programet e arsimit	**Kualifikimet aktualisht në dispozicion (Lloji)**	**Rolet potenciale të punës/ kërkesat profesionale**	
8	Arsimi i lartë-cikli i 3-të i Bolonjës (Doktorata)	Doktorata (A)	Hyrja në, ose vazhdimi i zhvillimit profesional brenda niveleve të ulëta të menaxhimit apo drejtimet profesionale të nivelit të lartë	8
7	Arsimi i lartë-cikli i 2-të i Bolonjës (Master)	Shkalla Master (A)		7
6	Arsimi i lartë-cikli i parë i Bolonjës (Bachelor)	Shkalla bachelor (A)		6
5	Cikli i shkurtër i Bolonjës dhe/ ose AAP post sekondar	Titulli i kualifikimit ende i pa njohur (A), (C) Certifikatat e ofruesve jo formal (D apo E)	Specialisti/Trajneri/Menaxheri	5
4	Përgatitja për progres në arsim të lartë dhe/ose hyrja në treg të punës	Diploma e maturës për lëndët e përgjithshme apo profesionale (B), (C), Diploma e arsimit profesional (C)	Punëtor/mbikëqyrësi i kualifikuar	4
3	Përgatitja për tregun e punës (të rinjtë dhe të rriturit)	Certifikata arsimore profesionale (C) Certifikata e ofruesve jo formal të APP-së (D apo E)	Punëtori gjysmë i kualifikuar	3
2	Progresi nga arsimi i mesëm i ultë tek ai i lartë (të rinjtë), përgatitja për tregun e punës (të rriturit)	Nuk janë definuar kualifikime ekzistuese të sistemit arsimor formal Certifikatat e ofruesve jo formal(D apo E)	Punëtori i pa kualifikuar	2
1	Arsimi fillor	Nuk janë definuar kualifikime ekzistuese të sistemit arsimor formal Certifikatat e ofruesve jo formal (E)	Niveli minimal i shkathtësive themelore, përfshirë shkollimin/numrin e nevojshëm për hyrje në nivelin më të ultë të punësimit	1

Niveli 1 parashikon kualifikimet e fituara pas përfundimit të kurseve kompensuese të arsimit bazik, ose kurseve të shkurtra të aftësimit, të ofruara nga ofruesit e aftësimit. Megjithatë, aktualisht nuk ofrohen kualifikime të tilla. Këto kualifikime janë ekuivalente me përfundimin e arsimit fillor.

Niveli 2 përfshin kualifikimet e fituara pas përfundimit të kurseve të shkurtra të aftësimit që mbulojnë shkathtësitë, apo shkathtësitë bazike profesionale/të punës të nivelit të ulët (shkrim-leximit, numërimit apo aftësi për TIK) të ofruara nga ofruesit jo-formal të aftësimit. Këto kualifikime janë ekuivalente me përfundimin e arsimit të mesëm të ulët.

Niveli 3 përfshin kualifikime që aktualisht fitohen pas përfundimit të dy viteve të arsimit formal të mesëm të lartë profesional dhe certifikatave të fituara pas përfundimit të kurseve të shkurtra të aftësimit, të ofruara nga ofruesit jo-formal të AAP-së.

Niveli 4 përfshin kualifikimin e Maturës të fituar pas përfundimit të arsimit të përgjithshëm dhe të mesëm të lartë profesional, certifikatave të fituara pas përfundimit të arsimit të mesëm të lartë profesional formal, si dhe certifikatat e fituara pas përfundimit të kurseve të shkurtra të aftësimit, të ofruara nga ofruesit jo-formal të AAP-së.

Niveli 5 parashikon kualifikimet akademike dhe profesionale (formale dhe jo-formale) që bien në mes të arsimit të mesëm dhe të lartë. Megjithatë, aktualisht nuk ofrohen

kualifikime të tilla.

Niveli 6 përfshin programe akademike dhe profesionale të arsimit të lartë, përfundimi i të cilave çon në një kualifikim me një titull të përgjithshëm Bachelor. Gjithashtu, janë parashikuar edhe kualifikimet e fituara pas përfundimit të kurseve të aftësimit të ofruara nga ofruesit jo-formal të AAP-së, por nuk ofrohen në këtë nivel.

Niveli 7 përfshin programe akademike dhe profesionale të arsimit të lartë, përfundimi i të cilave çon në një kualifikim me një titull të përgjithshëm Master. Gjithashtu, janë parashikuar edhe kualifikimet e fituara pas përfundimit të kurseve të aftësimit të ofruara nga ofruesit jo-formal të AAP-së, por nuk ofrohen në këtë nivel.

Niveli 8 përfshin programe akademike dhe profesionale të arsimit të lartë, përfundimi i të cilave çon në një kualifikim me një titull të përgjithshëm të Doktoratës.

5. REFERENCIMI I KKK-SË SË KOSOVËS ME KEK

5.1 PROCESI I REFERENCIMIT:

Procesi i referencimit të KKK-së së Kosovës me KEK i ka udhëzuar autoritetet kombëtare përgjegjëse për sistemin e kualifikimeve në përcaktimin e marrëdhënies ndërmjet KKK-së dhe niveleve të KEK. Shtojca 1 përmban një listë të pjesëmarrësve/institucioneve që ishin të përfshira në procesin e referencimit.

Korniza Evropiane e Kualifikimeve (KEK) vepron si një kornizë referuese për të bërë kualifikimet më të kuptueshme dhe të krahasueshme me njëra-tjetrën, në sisteme të ndryshme të arsimit dhe aftësimit në Evropë. Ajo ka për qëllim përmirësimin e mobilitetit të qytetarëve ndërmjet vendeve dhe sektorëve, si dhe lehtësimin e të mësuarit të tyre gjatë gjithë jetës.

KKK-ja e Kosovës synon përmirësimin e cilësisë dhe rëndësisë së arsimit dhe aftësimit, qasjes në punë dhe mësimit të mëtejshëm, duke u siguruar se kualifikimet janë relevante për punësim, mësim, dhe përmbushin nevojat e nxënësve, të ekonomisë dhe institucioneve të arsimit dhe aftësimit.

Procesi i referencimit i miratuar për këtë raport bazohet në **parimin e përshtatjes më të mirë** dhe ndërlidhet me:

- përshtatjen më të mirë të përgjithshme me nivelin e KEK për nivelin, ose kualifikimin e KKK-së;
- përshtatjen më të mirë të përgjithshme me llojin e përshkruesve të përcaktuar të nivelit (njohurive, shkathtësive, dhe përgjegjësive profesionale).

KEK është një iniciativë vullnetare, e cila bazohet në besimin reciprok ndërmjet shteteve anëtare. Grupi Këshillues i KEK-së ka propozuar **10 kritere dhe procedura të cilësisë** për referencimin e KKK-së me KEK-në. Këto kritere dhe procedura shërbejnë si udhëzime për shtetet anëtare që dëshirojnë të marrin pjesë në procesin e zbatimit të KEK, ku përdorimi i të cilave ndihmon për kryerjen e procesit të zbatimit në mënyrë transparente dhe koherente. Reagimi i Kosovës për çdo kriter:

5.2 KRITERET E REFERENCIMIT

Kriteri 1: Përgjegjësitë dhe/ose kompetenca ligjore e të gjitha organeve përkatëse kombëtare të përfshira në procesin e referencimit, duke përfshirë Pikën Koordinuese Kombëtare, janë përcaktuar në mënyrë të qartë dhe janë publikuar nga autoritetet kompetente publike.

Siç shpjegohet në Seksionin 3, sipas Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, AKK-ja është autoriteti përgjegjës për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e KKK-së. Sipas këtij ligji, një nga objektivat kryesore të KKK-së është sigurimi i një baze për bashkëpunim dhe njohje reciproke ndërmjet KKK-së dhe KEK. Si e tillë,

AKK-ja është Pika Koordinuese Kombëtare përgjegjëse për mbikëqyrjen e referencimit të KKK-së me KEK. Në përputhje me rrethanat, Këshilli Drejtues i AKK-së ka marrë vendim për fillimin e procesit të referencimit të KKK-së me KEK.

Pas këtij vendimi, AKK-ja ka themeluar tri grupe punuese (për arsimin e përgjithshëm, AAP dhe arsimin e lartë), të përbëra nga përfaqësues të palëve të interesuara, që janë në rolin e ekspertëve dhe këshilltarëve sektorial të KKK-së në procesin e referencimit. Palët e interesuara, të përfshira në grupet punuese, ishin: përfaqësuesit e AKK-së, MASHT-it, AKA-së, ofruesit publik dhe privat të arsimit dhe aftësimit, partnerët social, OJQ-të, donatorët, dhe projektet e donatorëve (shiko Shtojcën 1 për listën e plotë të pjesëmarrësve).

Sipas Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, përgjegjësia kryesore operative për KKK-në ndahet ndërmjet tri organeve të autorizuara, sipas llojit të kualifikimit, përkatësisht, AKK-ja është përgjegjëse për kualifikimet e arsimit dhe aftësimit profesional; MASHT-i për kualifikimet e arsimit të përgjithshëm; dhe AKA-ja për kualifikimet e arsimit të lartë.

Me qëllim të sigurimit të koherencës së kornizës së përgjithshme, i gjithë legjislacioni i arsimit (Ligji për Arsimin e Përgjithshëm, Ligji për AAP, Ligji për Arsimin e të Rriturve dhe Ligji për Arsimin e Lartë) është harmonizuar me Ligjin për Kualifikimet Kombëtare. Përveç kësaj, përfaqësuesit e MASHT-it dhe AKA-së janë anëtarë të Këshilli Drejtues të AKK-së.

Prandaj, me qëllim të sigurimit të inputeve dhe këshillës për procesin, përmes pjesëmarrjes në grupet përkatëse punuese, përfaqësuesit e këtyre tri institucioneve kanë qenë të përfshirë vazhdimisht në shqyrtimin e këtij raporti të referencimit.

Kriteri 2: Ekziston një lidhje e qartë dhe e dukshme ndërmjet niveleve të kualifikimit në Kornizën, ose Sistemin Kombëtar të Kualifikimeve dhe përshkruesit e niveleve të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve.

KEK është një kornizë e përbashkët referuese Evropiane, e cila vepron si një pajisje e përkthimit për t'i bërë kualifikimet më të lexueshme dhe kuptueshme nëpër vende dhe sisteme të ndryshme në Evropë. Ajo ka dy qëllime kryesore: promovimin e mobilitetit të qytetarëve ndërmjet vendeve dhe lehtësimin e mësimit të tyre gjatë gjithë jetës.

KKK-ja është një mjet që ka për qëllim qeverisjen e sistemit të kualifikimeve të ofruar në Kosovë, i bazuar në një sërë kriteresh për nivelet e specifikuara të arritura të nxënit. Siç shpjegohet në Seksionin 3, KKK-ja e Kosovës synon: sigurimin se kualifikimet e ofruara nga sistemi i arsimit dhe aftësimit janë relevante për punësim dhe mësim; rritjen e transparencës në lidhje me natyrën, marrëdhëniet dhe krahasueshmërinë ndërmjet kualifikimeve të ndryshme të ofruara; rritjen e cilësisë dhe rëndësisë së arsimit dhe aftësimit përmes promovimit të zhvillimit të kualifikimeve që janë të bazuara në standarde ndërkombëtarisht të krahasueshme të njohurive, shkathtësive dhe kompetencave dhe të mbështetura në sigurimin rigoroz të cilësisë.

Në të vërtetë KKK-ja e Kosovës ishte hartuar me qëllim, që nga fillimi, për të ofruar një bazë për bashkëpunim me KEK. Prandaj, KKK-ja e Kosovës është zhvilluar në përputhje me:

- Parimet dhe përkufizimet e Kornizës Evropiane të Kualifikimeve për të mësuarit gjatë gjithë jetës
- Përshkruesit të nivelit të KEK-së
- Parimet e cilësisë për AAP-në dhe arsimin e lartë, të bashkangjitura në KEK, si dhe kriteret relevante të KEK për referencimine KKK-së me KEK;
- Përshkruesit e Dublinit për arsimin e lartë;
- Kornizën për Kualifikime në Fushën Evropiane të Arsimit të Lartë (FQEHEA);
- Sistemin Evropian të Akumulimit dhe Transferit të Kredive (ECTS) dhe Sistemin Evropian të Kredive për Arsim dhe Aftësim Profesional;

- “Standardet dhe Udhëzimet Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Fushën e Arsimit të Lartë” të zhvilluara nga Rrjeti Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA);
- Kornizën Evropiane Referuese për Sigurim të Cilësisë për AAP (EQARF);
- Pakon e dokumenteve EUROPASS për transparencën e diplomave, certifikatave dhe kompetencave.

Në përputhje me rrethanat, janë ndërtuar ngjashmëritë në mes të KKK-së dhe KEK-së në lidhje me:

– Strukturën e kornizave, pasi që të dyja janë të bazuara në një strukturë prej 8 nivelesh, ku niveli 1 është niveli më i ulët dhe niveli 8 është niveli më i lartë, si dhe përfshijnë të gjitha nivelet dhe llojet e kualifikimeve, të fituara në arsimin dhe aftësimin profesional dhe akademik të përgjithshëm, për të rritur, fillestar dhe të vazhdueshëm,

– konceptet bazike themelore, pasi që të dyja bazohen në rezultatet e të nxënit të përshkruara në aspektin e njohurive (praktike dhe teorike), shkathtësive (praktike dhe njohëse) dhe kompetencave (fusha e autonomisë dhe përgjegjësisë personale).

Këto ngjashmëri, në aspektin e kritereve të projektimit dhe të kuptuarit të rezultateve themelore e të nxënit, mbi të cilat mbështeten të dy kornizat, mundësojnë një krahasim kuptimplotë mes tyre. Prandaj, është kryer një analizë gjuhësore, e cila krahason përshkruesit individual të nivelit e të dy kornizave, e cila është dhënë në detaje më poshtë.

Ekziston një korrespondencë e afërt ndërmjet gjuhës dhe koncepteve themelore që përdoren për përcaktimin e përshkruesit. Në përgjithësi, terminologjia e përdorur, d.m.th. shpjegimet e kompleksitetit të njohurive, shkathtësive dhe kompetencave, është e ngjashme për çdo nivel, edhe pse përshkruesit e KKK-së kanë tendencë të jenë më të detajuar dhe të përdorin më shumë deklarata për të përshkruar rezultatet e të nxënit. Për shembull, përshkruesit e nivelit 3 të KKK-së janë si vijon:

Njohuri - praktike dhe teorike:

Ata duhet të kenë njohuri të punës të aspekteve kryesore të lëndës arsimore,profesionit, apo fushës profesionale dhe do të jenë në gjendje ta përdorin këtë njohuri për të arritur rezultatet e mësimit të strukturuar, apo atë në vendin e punës. Kjo do të përfshijë faktet, parimet, proceset dhe idetë që atyre ju nevojiten për të realizuar mësim të strukturuar, apo për të punuar me sukses në këtë lëmi , profesion apo fushë profesionale.

Shkathtësitë – praktike dhe njohëse:

Ata do të jenë ne gjendje të aplikojnë një numër të shkathtësive njohëse dhe praktike, të nevojshme për të kryer detyra dhe zgjidhur probleme në një lëmi arsimore, profesion apo fushë profesionale. Kjo do të arrihet duke përdorur informacione (si ato të renditura tek njohuritë në këtë nivel) përdorimi i metodave të përshtatshme dhe zbatimi i tyre duke përdorur mjete dhe materiale të përshtatshme. Puna nuk do të jetë ende në nivelin e kërkuar për një punëtor të kualifikuar, apo për hyrje në studime në arsimin e lartë.

Përgjegjësia personale:

Ata do të jenë në gjendje të bartin përgjegjësinë për realizimin e këtyre detyrave, zgjedhjen e problemeve dhe realizimin e rezultateve për këtë nivel. Ata do të kryejnë detyra pa mbikëqyrje. Ata do të jenë në gjendje të zgjedhin detyra rutinore në këtë lëmi arsimore, profesion, apo fushë profesionale dhe do të mund të bëjnë ndryshime në qasje ndaj detyrës atëherë kur kjo kërkohet.

Rezultatet e mësimit për nivelin e 3 të KEK janë përshkruar përmes njohurive, shkathtësive dhe

kompetencave, në këtë mënyrë:

> **Njohuritë:** njohuri të fakteve, parimeve, proceseve dhe koncepteve të përgjithshme, në një fushë të punës së studimit
>
> **Shkathtësitë:** një varg i shkathtësive njohëse dhe praktike të kërkuara për përmbushjen e detyrave dhe zgjidhjen e problemeve përmes përzgjedhjes dhe aplikimit të metodave, mjeteve, materialeve dhe informacioneve bazike.
>
> **Kompetencat:** të marrin përgjegjësinë për përfundimin e detyrave në studimin/ të përshtatin sjelljet e tyre me rrethanat rreth zgjidhjes së problemeve.

Është kryer një krahasim për secilin nivel, i cili është paraqitur në Tabelën 3, me kodin e mëposhtëm:

- ngjashmëritë në rezultatet e të nxënit në të gjitha nivelet e kornizave janë të hijezuara dhe të lidhura me shigjeta
- dallimet e vërejtura janë shpjeguar në një fusnotë dhe përmbledhur më poshtë.

Sa i përket përshkruesve të nivelit 1 deri në 8, nuk ka dallime thelbësore të vërejtura ndërmjet deklaratave të rezultateve e të nxënit të KEK dhe të KKK-së.

Rezultatet e të nxënit të KKK-së janë të elaboruara më gjerësisht se ato të KEK, por demonstrojnë të njëjtin kuptim dhe rëndësi. Dallime të vogla duket të jenë në përshkruesit e niveleve 4, 5, 7 dhe 8. Në nivelin 4 në përshkruesin e njohurisë, KEK i referohet si “njohuri faktike dhe teorike”, ndërsa KKK-ja i referohet si “njohuri të mira”. Në nivelin 5 të përshkruesit të shkathtësive, KEK i referohet si “probleme abstrakte”, ndërsa KKK-ja i referohet si “probleme praktike”. Në nivelin e 7 në përshkruesin e shkathtësive, përgatitja e tezave të Master-it paraqitet si një rezultat i të nxënit në KKK, ndërsa jo në KEK. Në nivelin 8, përgatitja e tezës së doktoratës paraqitet si një rezultat i të nxënit në KKK, ndërsa në KEK jo.

Prandaj, në bazë të analizës krahasuese të treguesve dhe përshkruesve të niveleve në KKK dhe KEK, mund të thuhet se përshkruesit e KKK-së korrespondojnë me përshkruesit e KEK.

TABELA 3

	Përshkruesit e KEK	Përshkruesit e KKK	Niveli i KEK/KKK
K	**Njohuria e përgjithshme** themelore	Ata duhet të jenë në gjendje të marrin dhe përdorin njohuritë e domosdoshme, për të mësuar, kryer punët e thjeshta, apo të jenë pjesëmarrës në jetën e përditshme. Kjo **njohuri është e përgjithshme** – d.m.th. nuk është specifike për një lëmi mësimore, apo për një profesion, apo për një fushë profesionale.	1
S	**Shkathtësi bazike** të nevojshme për kryerjen e **detyrave të thjeshta**	Ata do të jenë në gjendje të kryejnë **detyra të thjeshta** duke përdorur **shkathtësi bazike** – p.sh. detyra të përditshme, të cilat kërkojnë shkathtësi leximi, shkrimi, përdorimin e numrave, kryerjen e proceseve themelore me kompjuter, punën brenda një strukture të mbikëqyrur, apo punën me njerëzit e tjerë.	
C	Puna, apo studimi në **mbikëqyrjen direkte** në një **kontekst të strukturuar**	Ata do të jenë në gjendje të ndërmarrin **punë, apo mësim të strukturuar**, i cili **organizohet dhe kontrollohet** nga njerëzit e tjerë. Ata do të kryejnë detyra nën **mbikëqyrjen direkte, apo të shpeshtë** dhe nuk do të mbajnë përgjegjësi të plotë për të vendosur se çfarë duhet të bëhet si, kur, apo ku duhet të bëhet, apo rreth cilësisë së rezultateve të asaj detyre.	
K	**Njohuria faktike themelore** e një fushe të punës, apo studimit	Ata do të jenë në gjendje të mësojnë dhe përdorin **njohurinë bazike** për një lëndë arsimore, profesion, apo fushë profesionale. **Njohuria kryesisht do të jetë faktike** – p.sh. informacione rreth përmbajtjes së zakonshme, terminologjisë, proceseve, mjeteve, apo materialeve të një lënde arsimore, profesioni, apo fushe profesionale.	2
S	**Shkathtësitë bazike njohëse dhe praktike** kërkojnë përdorimin e informacioneve përkatëse me qëllim të kryerjes së detyrave dhe zgjidhjes së **problemeve rutinore duke përdorur rregulla dhe mjete të thjeshta**	Ata do të jenë në gjendje t'i kombinojnë **shkathtësitë themelore praktike dhe shkathtësitë themelore e të menduarit**, përmes përdorimit të informacioneve të renditura në kuadër të njohurive në këtë nivel. Shkathtësitë do të përfshijnë **arsyetimin, llogaritjen dhe planifikimin për kryerjen e detyrave, si dhe zgjidhjen e problemeve** të cilat janë të zakonshme për lëndën, profesionin, apo fushën profesionale. Kjo do të kryhet duke ndjekur praktika **rutinore të bazuara në rregulla të qarta, duke përdorur mjete dhe material të thjeshta.**	
C	**Puna, apo studimi nën mbikëqyrje, me pak autonomi**	Ata do të jenë në gjendje të kryejnë detyra në mbikëqyrje të **përgjithshme, apo të plotë**. Këto detyra do të organizohen kryesisht dhe kontrollohen nga të tjerët, por që **individët do të bartin përgjegjësinë për disa aspekte të detyrave** (si marrja e vendimeve se çfarë duhet të bëhet, si dhe kur, apo ku duhet të bëhet), si dhe kualitetin e disa rezultateve.	

	Përshkruesit e nivelit të KEK	Përshkruesit e nivelit të KKK-së në Kosovë	Niveli i KEK/KKK
K	**Njohuri për faktet, parimet, dhe konceptet e përgjithshme** në fushën e punës, apo studimit	Ata duhet të kenë **njohuri të punës** të aspekteve kryesore të lëndës arsimore, profesionit, apo fushës profesionale dhe do të jenë në gjendje ta përdorin këtë njohuri për të arritur rezultatet e mësimit të strukturuar, apo atë në vendin e punës. Kjo do të përfshijë **faktet, parimet, proceset dhe idetë** që u nevojiten atyre për të realizuar mësim të strukturuar, apo për të punuar me sukses në këtë lëndë, profesion, apo fushë profesionale.	3
S	Një varg i **shkathtësive njohëse dhe praktike** që kërkohen për përmbushjen e detyrave dhe zgjidhjen e problemeve **përmes përzgjedhjes dhe aplikimit të metodave, mjeteve, materialit dhe informacioneve themelore**	Ata do të jenë në gjendje të aplikojnë një numër të **shkathtësive praktike dhe të të menduarit për kryerjen e detyrave dhe zgjidhjen e problemeve** në një lëndë arsimore, profesion, apo fushë profesionale. Kjo do të arrihet duke **përdorur informacione** (si ato të renditura te njohuritë në këtë nivel) për zgjedhjen e **metodave të përshtatshme** dhe zbatimin e tyre me **materiale dhe mjete të përshtatshme**. Puna nuk do të jetë ende në nivelin e kërkuar për një punëtor të kualifikuar,apo për hyrje në studime në arsimin e lartë.	
C	**Bartin përgjegjësi** për kryerjen e detyrave në punë, apo studim **Përshtatin sjelljen e tyre** me rrethanat për **zgjidhjen e problemeve**	Ata do të jenë në gjendje **të bartin përgjegjësi për realizimin e detyrave**, zgjidhjen e problemeve, dhe arritjen e rezultateve për këtë nivel. Ata do të kryejnë detyra pa mbikëqyrje. **Ata do të jenë në gjendje të zgjidhin problemet** të cilat janë rutinore në lëndën arsimore, profesion, apo fushë profesionale dhe **të bëjnë ndryshime në qasjen ndaj detyrës atëherë kur kjo kërkohet.**	
K	**Njohuria faktike dhe teorike** në kontekst të gjerë brenda një fushe të punës, apo studimit	Ata do të kenë **njohuri të mira**[6] **në dhe rreth** një lënde arsimore, profesioni, apo fushe profesionale. Ata do të jenë në gjendje të përdorin këtë njohuri për kryerjen e mësimit të strukturuar, apo punën në atë fushë, profesion, apo fushë profesionale.	4
S	Një varg i **shkathtësive njohëse dhe praktike** kërkohet për gjenerimin e zgjidhjeve për **probleme specifike** në një fushë të **punës**, apo studimit	Ata do të jenë në gjendje të aplikojnë një numër **të shkathtësive praktike dhe të të menduarit** për të kryer detyrat dhe **zgjidhur problemet**. Shkathtësitë, detyrat dhe problemet do të jenë **të veçanta** për lëndën arsimore, profesionin, apo fushën profesionale. Ata do të marrin detyra në nivel të punëtorit të kualifikuar, apo të mësimit të strukturuar në nivelin e kërkuar për hyrje në studime në arsimin e lartë.	
C	Ushtrojnë **vetë-menaxhimin** brenda udhëzimeve të kontekstit të punës, apo studimit, të cilat janë zakonisht të parashikueshme por janë **subjekt i ndryshimit**. **Mbikëqyrin punën rutinore të të tjerëve** duke marrë përgjegjësi për **vlerësimin** dhe **përmirësimin** e aktiviteteve të punës, apo studimit.	Ata do të **jenë në gjendje të bëjnë ndryshime në qasjen e tyre të planifikuar gjatë ndërmarrjes së aktiviteteve të tyre.** Ata do të **punojnë në mënyrë të pavarur dhe do të marrin përgjegjësinë e plotë** për **planifikimin dhe përfundimin** e punëve, apo të mësimit të strukturuar dhe për cilësinë e rezultateve. Ata do të **vlerësojnë performansën e tyre** dhe përpiqen që ta përmirësojnë atë. Ata mund të **mbikëqyrin të tjerët të cilët janë të ngarkuar me aktivitete rutinore**, **vlerësojnë performansën e tyre** dhe marrin hapa **bërë përmirësime** mbi bazën e këtij vlerësimi.	

K	**Njohuria gjithëpërfshirëse, e specializuar, faktike dhe teorike brenda një fushe të punës,** apo studimit dhe një **ndërgjegjësim për kufijtë e asaj njohurie.**	Ata duhet të kenë njohuri të gjëra dhe të specializuara faktike dhe teorike në dhe rreth një lënde arsimore, profesioni, apo fushe profesionale. Ata do të jenë në gjendje të përdorin njohuritë e tyre për të arritur rezultate të cilat rrjedhin nga mësimi i strukturuar, ose puna. Kjo mund të përfshijë: • përdorimin **e njohurive të gjëra dhe të specializuara faktike dhe teorike** brenda një fushe të punës, apo studimit duke treguar **vetëdijesim dhe kufizime të këtyre njohurive;** • zbatimin e njohurive të gjëra për fushëveprimin, definimin e veçorive dhe fushave kryesore të lëndës, fushës profesionale dhe njohurive të detajuara në disa fusha; • të kuptuarit dhe përdorimin e një vargu të limituar të teorive bazike, parimeve dhe koncepteve; • përdorimin e njohurive dhe të kuptuarit e disa prej çështjeve aktuale më kryesore specializimeve dhe në bazë të njohurive të theksuara t'i kuptojnë hulumtimet, apo proceset ekuivalente brenda kontekstit të punës, apo studimit.	
S	Një rradhë **gjithëpërfshirëse të shkathtësive njohëse dhe praktike** të nevojshme për gjetjen e zgjidhjeve kreative ndaj problemeve **abstrakte.**	Ata do të jenë në gjendje të përdorin një grumbull shkathtësish të specializuara të cilat nevojiten për të planifikuar, zbatuar, rishikuar dhe vlerësuar rezultatet në një lëndë arsimore, profesion, apo fushë profesionale. Ata do të jenë në gjendje të zbatojnë shkathtësitë gjithëpërfshirëse njohëse dhe praktike, praktikave dhe teknikave për të zhvilluar **zgjidhje kreative për problemet praktike**[7] dhe përmbushjen e detyrave. Kjo mund të përfshijë: • zbatimin e shkathtësive hulumtuese dhe analitike për zgjidhjen e problemeve konkrete dhe **abstrakte** dhe çështjeve që kërkojnë ushtrimin e maturisë dhe gjykimit; • ndërmarrjen e hetimit, analizës dhe interpretimit, që kërkon aplikimin e teorive, parimeve dhe metodave relevante për fushën e punës ose studimit; • përdorimin e një rangu të shkathtësive të komunikimit, atyre matematikore dhe digjitale, të ndërlidhura me një fushë të punës ose studimit, një pjesë e të cilave është e avancuar, ose e specializuar.	
C	Ushtrojnë **menaxhimin dhe mbikëqyrjen** në kontekstet e aktiviteteve të punës, apo studimit ku ka **ndryshime të paparashikueshme** **Shqyrtoni dhe zhvilloni performansën tuaj dhe të të tjerëve**	Ata do të jenë në gjendje të realizojnë punë të pavarur, apo mësim të strukturuar të të gjitha llojeve të radhitura për këtë nivel, përfshirë adoptimet për të përmbushur **kërkesat e ndryshimeve dhe rrethanave, ose për t'u marrë me faktorët, ose zhvillimet e paparashikuara**. Kjo mund të përfshijë: • Ushtrimin e autonomisë së konsiderueshme personale dhe marrjen e iniciativës në disa veprimtari që kërkojnë ushtrimin e maturisë dhe gjykimit; • Ushtrimin e **menaxhimit dhe mbikëqyrjes** në kontekstet e punës apo studimit, e cila mund të përfshijë organizimin dhe marrjen e përgjegjësisë për punën e të tjerëve dhe për burimet dhe/ose menaxhimin e aktiviteteve të njerëzve të tjerë; • **Rishikimin dhe vlerësimin e performansës personale dhe të tjerëve** për të cilët është marrë përgjegjësi dhe planifikimin e përmirësimeve në performansë në bazë të një vlerësimi të tillë.	

	EQF level descriptors	NQF Descriptors	Level
K	• njohuri të avancuara në një fushë të punës, ose studimit duke përfshirë një të kuptuar kritik të teorive dhe parimeve	Njohuria – e avancuar **Ata duhet të kenë njohuri të avancuara në dhe rreth fushës së punës apo studimit, përfshirë të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve.** Kjo mund të përfshijë: • përdorimin e njohurive të integruara të parimeve, karakteristikave, kufijve dhe terminologjisë në kuadër të një lënde, disipline apo fushe të punës për të arritur gjykim të informuar rreth teorive dhe praktikave, apo për të udhëhequr atë; • shfrytëzimin e njohurive të detajuara dhe të kuptuarit në një, ose më shumë specializime, që janë pjesa më e avancuar e një lënde, disipline, ose fushe të punës; • demonstrimin e njohurive dhe të kuptuarit e mënyrave të zhvillimit të një lënde, disipline, ose fushe të punës, duke përfshirë një radhë të teknikave të përcaktuara të mbledhjes së të dhënave, ose metodologjitë e hulumtimit.	6
S	• **Shkathtësitë e avancuara, duke demonstruar mjeshtëri dhe inovacion, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikuara në një fushë të specializuar të studimit, ose të punës**	Shkathtësitë – praktike të avancuara, njohëse dhe kreative Ata do të jenë në gjendje të **demonstrojnë mjeshtërinë dhe inovacionin për të zgjidhur problemet komplekse dhe të paparashikuara, në fushën e specializuar të punës ose studimit**. Kjo mund të përfshijë: • përdorimin e disa shkathtësive, praktikave dhe/ose materialeve të specializuara dhe të avancuara ose që janë parësore në një lëndë, disiplinë apo fushë të punës; • ekzekutimin e projekteve të definuara të hulumtimit, zhvillimit, apo hetimit për identifikimin dhe zbatimin e rezultateve relevante; • **përcaktimin në një radhë të kontekseve të nivelit profesional, që përfshinë një shkallë të pa parashikueshmërisë dhe/ose të specializimit dhe demonstrimin e origjinalitetit dhe kreativitetit dhe të gjykuarit në situata kur të dhënat/informacionet janë të limituara ose rrjedhin nga burime të ndryshme**	
C	• **menaxhoni aktivitetet teknike ose profesionale, duke marrë përsipër përgjegjësinë për marrjen e vendimeve në kontekstet e paparashikueshme të punës, ose studimit** • **merrni përgjegjësi për menaxhimin e zhvillimit profesional të individëve, apo grupeve**	Ata do të realizojnë detyra apo studime, të cilat përfshijnë **menaxhimin e aktiviteteve, apo projekteve komplekse teknike dhe/ose profesionale, të cilat mund të përfshijnë përgjegjësinë për vendimmarrje në kontekste të paparashikuara të punës, ose studimit apo të menaxhojnë zhvillimin profesional të individëve dhe grupeve.** Kjo mund të përfshijë: : • punën efektive nën udhëheqje, në bashkëpunim me kolegët tjerë të kualifikuar; • ushtrimin e autonomisë dhe iniciativës dhe marrjen e përgjegjësisë kryesore për punën e të tjerëve dhe për një radhë të burimeve; • bashkëpunimin me të tjerët për të siguruar ndryshime, zhvillim dhe/ose ide të reja; • marrjen me çështjet etike dhe profesionale në pajtim me kodet dhe praktikat ekzistuese profesionale	

K	• **njohuri shumë të specializuara, një pjesë e të cilave janë pjesë thelbësore të njohurive të një fushë të punës apo studimit, si bazë për të menduarit origjinal dhe /ose hulumtim** • **vetëdijesim kritik ndaj çështjeve në një fushë** dhe ndaj lidhshmërisë ndërmjet fushave të ndryshme	Njohuri – shumë të avancuara Ata do të kenë njohuri shumë të **specializuara, të gjera dhe të hollësishme, disa prej të cilave janë themelore në një fushë të punës, ose studimit dhe të cilat ndërlidhen me fusha të ndryshme, si bazë për të menduarit origjinal dhe ose/hulumtim**. Kjo do të përfshijë: • **një kuptim kritik i teorive kryesore, parimeve dhe koncepteve që ndërlidhen me njohuri praktike dhe konceptuale të lëndës,** disiplinës ose fushës së punës – duke përfshirë specializimet relevante; • puna me njohuritë, të cilat mbulojnë dhe integrojnë shumicën e fushave kryesore të lëndës, disiplinës, ose fushës së punës – duke përfshirë tiparet e tyre, kufijtë, terminologjinë dhe marrëveshjet; • **mbështetja në vetëdijen kritike mbi çështjet aktuale të një lënde, disipline, ose fushe të punës duke përfshirë specializimet përkatëse.**	7
S	• **shkathtësitë e specializuara për zgjidhjen e problemit të nevojshme në** hulumtim dhe/ose inovacion me qëllim të **zhvillimit të njohurive dhe procedurave të reja dhe integrimit të njohurisë nga fusha të ndryshme**	Shkathtësitë – shumë të specializuara praktike, njohëse dhe kreative Ata do të jenë në gjendje të të përdorin **shkathtësitë dhe teknika shumë të specializuara të ndërlidhura me një lëndë /disiplinë** fushë profesionale, duke përfshirë edhe disa që mund të jenë në ballë të zhvillimeve, për kryerjen e aktiviteteve, të cilat kërkojnë të menduar të konsiderueshëm inovativ dhe/ose kërkime origjinale. Ata do të kenë mundësinë dhe qëndrim të vlerësojnë informatat e reja, konceptet dhe dëshmitë nga një game e gjerë e burimeve dhe duhet të jenë në gjendje të përdorin shkathtësitë e specializuara për **zgjidhjen e problemeve për zhvillimin e njohurive dhe procedurave të reja dhe integrimin e njohurive nga fushat e ndryshme**. Kjo mund, për shembull, të përfshijë: • planifikimin dhe kryerjen e një projekti të rëndësishëm të hulumtimit, hetimit ose zhvillimit; • zhvillimin e përgjigjeve origjinale dhe kreative për problemet dhe çështjet e praktikuara në një shumëllojshmëri të gjerë, dhe shpesh të paparashikueshme, kontekstesh profesionale; • **hartimin e temës për master**[8]	
C	• **menaxhoni dhe transformoni kontekstet e punës dhe studimit, të cilat janë komplekse, të paparashikueshme dhe kërkojnë qasje të reja strategjike** • **merrni përgjegjësi për të kontribuar në njohuritë dhe praktikat profesionale dhe/ose për rishikiminin e performansës strategjike të ekipeve**	Ata do të ushtrojnë autonomi substanciale dhe iniciativë në veprimtaritë profesionale dhe ekuivalente, duke marrë përgjegjësinë për punën e vet dhe/ose përgjegjësi të konsiderueshme për punën e të tjerëve, dhe ndërmarrjen e punës, ose studimit që përfshin **menaxhimin dhe transformimin e kontekseve të punës apo studimit, të cilat janë komplekse, të paparashikuara dhe që kërkojnë qasje të reja strategjike**. Kjo mund të përfshijë: • **Menaxhimin e ekipeve të profesionistëve, duke kontribuar në zhvillimin e njohurive të tyre dhe praktikën dhe/ose shqyrtimin e performansës së tyre;** • trajtimin e çështjeve komplekse etike dhe profesionale dhe sjellja e vendimeve mbi çështjet, të cilat nuk janë të adresuara nga kodet, ose praktikat aktuale profesionale	

K	• njohuri në kufijtë më të avancuar të një fushe të punës, ose studimit dhe në lidhshmërinë midis fushës	Njohuri – shumë të avancuara Ata do të kenë dhe përdorin **njohuri shumë të avancuara në një fushë të punës, studimit apo fushë hulumtuese dhe në ndërlidhjen në mes të fushave të ndryshme**, nxjerrjen e përfundimeve nga rishikimi kritik i një lënde /disipline, duke përfshirë të kuptuarit kritik të teorive, parimeve dhe koncepteve. Njohuria dhe të kuptuarit gjenerohet përmes hulumtimit personal, apo punës ekuivalente që e bën një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e subjektit/disiplinës dhe ofron njohuri origjinale dhe kreative në ide informacione dhe çështje të reja, komplekse dhe/ose abstrakte, duke zhvilluar reagime kreative dhe origjinale ndaj problemeve. Kjo do të përfshijë: • punën me çështje shumë komplekse dhe/ose të reja dhe të gjykuarit në mungesë të të dhënave/ informacioneve të plota ose të qëndrueshme; • **Shtrimin ose ridefinimin e njohurisë dhe praktikave profesionale brenda një fushe të caktuar, ose në ndërlidhjen ndërmjet fushave.**	
S	• **shkathtësitë dhe teknikat më të avancuara dhe të specializuara, përfshirë sintezat dhe vlerësimet, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve kritike, gjatë hulumtimeve ose inovacioneve, si dhe për zgjerimin dhe ri-definimin e njohurive ose praktikës profesionale ekzistuese**	Shkathtësitë – praktike shumë të avancuara, njohëse dhe kreative Ata do të jenë në gjendje të përdorin **një varg të shkathtësive, teknikave, praktikave dhe** materialeve në ballë të një lënde, disiplinës ose fushës së punës në fushën e punës me qëllim të arritjes së njohurive në ide, informacione dhe çështje të reja, komplekse dhe/ose abstrakte dhe zhvillimin e reagimeve kreative dhe origjinale ndaj problemeve. Kjo do të përfshijë aplikimin e një sërë metodash standarde dhe të specializuara të hulumtimit dhe kërkimit (**p.sh. sintezës dhe vlerësimit**) për të dizajnuar dhe kryer projektet hulumtuese, hetuese apo zhvillimore **me qëllim të zgjidhjes së problemeve kritike dhe/ose zgjerimit dhe ridefinimit të njohurisë, apo praktikës profesionale ekzistuese**, duke rezultuar në kontribute të rëndësishme në njohuri dhe të kuptuarit dhe/ose zbatimin e njohurisë brenda një disipline, apo fushe arsimore. Kjo ka gjasë të përfshijë: • Rishikimin e literaturës, eksperimentimin dhe qasje të tjera sistematike për një varg të njohurive; • Shkrimin e vështrimeve kritike në një apo më shumë fusha të specializimit ose fushave kërkimore; • **Përgatitja e tezës së doktoraturës**[9].	8
C	• **demonstrimi i autoriteteve, inovacioneve, autonomisë thelbësore, dhe integritetit profesional, si dhe përkushtim të vazhdueshëm në zhvillimin e ideve, apo proceseve të reja në ballë të kontekseteve të punës apo studimit, përfshirë edhe hulumtimin**	Ata do të ushtrojnë nivel të lartë të autonomisë dhe iniciativës në aktivitetet profesionale dhe ekuivalente, **duke demonstruar autoritet thelbësor, inovacion dhe autonomi, integritet arsimor dhe profesional dhe përkushtim të vazhdueshëm në zhvillimin e ideve dhe proceseve të reja që janë në nivelet më të larta të kontekseteve të punës, studimit apo hulumtimit** në fushën, ose disiplinën relevante. Ata gjithashtu do të marrin përgjegjësi të plotë për punën personale dhe/ose përgjegjësinë kryesore për punën e të tjerëve, duke demonstruar lidership dhe/ose origjinalitet në trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve. Ata duhet të jenë në gjendje të merren me çështje komplekse etike dhe profesionale, gjykimin e çështjeve të reja të pa adresuara nga kodet, apo praktikat aktuale profesionale dhe/ose etike.	

Kriteri 3: Korniza kombëtare, ose sistemi i kualifikimeve dhe kualifikimet e saj, janë të bazuara në parimin dhe objektivin e rezultatit e të nxënit dhe të ndërlidhura me rregullimet për validimin e mësimit jo-formal dhe informal, si dhe të sistemeve të kredive, aty ku ato ekzistojnë

Ekziston një qasje e qëndrueshme në të gjithë sektorët e arsimit në përdorimin e rezultatit e të nxënit,duke pasur parasysh se qëllimi i KKK-së është zvogëlimi i pengesave ndërmjet sektorëve të ndryshëm të arsimit dhe aftësimit.

6) *KEK deklaron: "njohuria faktike dhe teorike … brenda një fushe të punës apo studimit"; ndërsa KKK-ja deklaron "njohuri të mira në dhe rreth një lënde arsimore, profesioni, apo fushë profesionale". Edhe pse termet e sakta janë të ndryshme, duket të ketë një shkallë të krahasueshmërisë këtu..*
7) *KEK i referohet si probleme abstrakte, ndërsa KKK-ja si problem praktike.*
8) *Përgatitja e një teme Masteri të shfaqet si një rezultat i të nxënit në KKK, por jo në KEK*
9) *Përgatitja e tezës së doktoratës paraqitet si rezultat i mësimit në KKK, ndërsa në EQF jo.*

Sistemi i arsimit të përgjithshëm

Kualifikimet e arsimit të përgjithshëm janë të bazuara në rezultatet e të nxënit, të përcaktuara për secilin nivel të arsimit, siç parashihet në KKK. Kompetencat kryesore të parapara në KKK rrjedhin nga qëllimet e përgjithshme të arsimit para-universitar në Kosovë dhe përcaktojnë rezultatet kryesore e të nxënit që nxënësit duhet t`i arrijnë në mënyrë progresive dhe të vazhdueshme gjatë tërë sistemit arsimor para-universitar.

KKK-ja përcakton gjashtë kompetencat kryesore që duhet të fitohen gjatë arsimit të detyruar:

- Kompetenca e komunikimit dhe e shprehjes
- Kompetenca e të menduarit
- Kompetenca e të mësuarit
- Kompetenca e lidhur me jetën, punën dhe ambientin
- Kompetenca personale
- Kompetenca qytetare

Megjithatë, duhet cekur se këto kanë për qëllim të aplikohen gjatë gjithë kurrikulës shkollore, përfshirë programet e përgjithshme arsimore, dhe ato ofrojnë një mori të plotë të "shkathtësive të buta" të nevojshme për të mbështetur kompetencën profesionale.

Arsimi i përgjithshëm është tërësisht i bazuar në rezultatet e të nxënit sipas KKK-së, por nuk ka kualifikime dalëse për arsimin parashkollor. Për ata që kryejnë arsimin fillor dhe të mesëm të ulët ka kualifikime që jepen si certifikata dalëse (dëftesa).

Matura është kualifikim dalës për nxënësit e shkollave të arsimit të përgjithshëm

(gjimnaze) dhe për ata që dëshirojnë të avancohen në arsimin e lartë nga shkollat profesionale.

Nuk ka aranzhime për validimin e mësimit jo-formal dhe informal dhe nuk ka sistem të kredive në arsimin e përgjithshëm.

Sistemi i AAP dhe arsimit për të rritur

Është i përcaktuar në Ligjin e vitit 2008 për Kualifikimet Kombëtare dhe në aktet nënligjore, përfshirë Udhëzimin Administrativ të përditësuar mbi kriteret për validimin e kualifikimeve), që kualifikimet e reja të AAP-së duhet të bazohen në rezultatet e të nxënit. KKK-ja ka ndikuar në Kurrikulë dhe ndryshime tjera arsimore. Termat "modul" dhe "njësi" janë kuptuar gjerësisht në sistemin tonë të AAP-së para prezantimit të KKK-së, megjithëse sistemi modular është futur tash së fundi në arsimin profesional në Kosovë. Tradicionalisht, Kurrikulat kanë qenë të bazuara në lëndë, me dallim në teori dhe praktike në secilën lëndë. Kurrikulat modulare u prezantuan dhe pilotuan nga donatorë të ndryshëm qysh nga viti 2002 e këtej. Deri tani vetëm Kurrikulat e mbështetura nga donatorët ishin modulare. Megjithatë, reforma më e fundit e Kurrikulës nga MASHT-i dhe AKK-ja ka prezantuar modularizimin për tërë sistemi.

Përdorimi i standardeve profesionale

Standardet e profesionit janë pika fillestare për Kurrkulat e bazuara në rezultate dhe kualifikimet e AAP-së të bazuara në rezultate. Kualifikimet e AAP-së mund të vendosen në KKK, nëse ato janë të bazuara në standarde të profesionit. Standardet e profesionit janë zhvilluar në bashkëpunim me: MASHT, MPMS dhe ministritë tjera relevante si dhe partnerët social. Përveç kësaj, ato janë verifikuar nga AKK-ja dhe miratuar nga KAAP.

Figura 1- paraqet një shembull të fazave të zhvillimit të standardeve të profesionit,të cilat duhet të ndiqen dhe të evidentohen nga aplikuesit.




Figura 1: Fazat e zhvillimit të standardeve të profesionit (paraqet një shembull për murator)

Standardet e profesionit, të cilat dërgohen për verifikim në AKK duhet t'i plotësojnë kriteret e mëposhtme: Standardet e profesionit duhet që:


- » të hartohen në formatin e përcaktuar nga AKK-ja, bazuar në funksionet, aktivitetet kyçe, kriteret e performances, njohuritë e nevojshme për të kryer funksionin, shkathtësitë dhe kompetencat kyçe që lidhen me funksionin kryesor;
- » të bazohen në kërkesën e tregut të punës;
- » të zhvillohen në bashkëpunim me të gjithë akterët;
- » të kenë një periudhë të validitetit; dhe
- » të jenë titulluar dhe koduar sipas Listës së Klasifikimit të Profesioneve në Kosovë, ISCO 88, ILO dhe standardet e tjera ndërkombëtare.

Për secilin standard të profesionit të zhvilluar nga AKK-ja (një shembull i dhënë në Shtojcën 5) ekziston formati standard, e i cili duhet të zbatohet nga të gjitha institucionet që aplikojnë për verifikimin e standardeve, por gjithashtu është duke u aplikuar nga MASHT-i dhe MPMS-ja për zhvillimin e standardeve të profesionit në rastet kur nuk janë dorëzuar ende tek AKK-ja për verifikim. Formati i standardeve të profesionit përfshin funksione të gjera; çdo funksion i gjerë është i ndarë në aktivitetet kryesore, të cilat i përshkruajnë kërkesat e funksionit të gjerë. Për secilin aktivitet kyç, janë disa deklarata

të performancës, të cilat përshkruajnë rezultatet e performancës që duhet të arrihet në qoftë se kompetencat dhe funksionet e gjera janë kryer me sukses. Figura 2- paraqet strukturën e standardeve të profesionit, dhe një shembull i një standardi të profesionit është paraqitur në Shtojcën 5.

Figura 2: Struktura e standardeve të profesionit

A typical example of the structure of occupational standards:



Aktualisht ekzistojnë 25 standarde të profesionit, të zhvilluara, të verifikuara dhe të miratuara në nivel kombëtar.

Standardet e profesionit përdoren për të ofruar një pikë referimi për identifikimin e moduleve që duhet të përfshihen në secilin kualifikim, së bashku me rezultatet e të nxënit që duhet të arrihen për kandidatin që do të kreditohet pas kryerjes së secilit modul.

Në përgjithësi, funksionet kryesore të identifikuara në standardet e profesionit do të çojnë në përcaktimin e moduleve për nxënie dhe vlerësim. Modulet ofrojnë blloqe ndërtimi për kualifikime, duke mundësuar zhvillimin e sistemit të akumulimit të kredive dhe transferimit të kredive. Moduleve mund t'iu jepen vlerat e kredive në bazë të madhësisë së modulit.

Ato mund të ofrohen në kombinime të përshkruara për të përmbushur kërkesat e programeve të veçanta, si opsione zgjedhore ose individualisht. Zakonisht kualifikimet profesionale bazohen në një strukturë "bërthamë" dhe "zgjedhore", duke mundësuar një shkallë të zgjedhjes në lidhje me modulet e marra. Kualifikimet mund të përcaktojnë strategjinë e vlerësimit që duhet të përmbushet për dhënien e kualifikimit të plotë, dhe kjo duhet t'ia mundësojë nxënësit grumbullimin e kredive për modulet. Ekziston një format i përbashkët, ose model i përdorur për të përcaktuar standardet për kualifikimet, më saktë brenda moduleve.

Titulli i kualifikimit:	**Vlera e kredive:** .....
Titulli i modulit:	**Niveli i modulit në KKK:** .....

Rezultat i mësimit 1:	**Rezultat i mësimit 2:**
• Performanca (vlerësimi) kriteri ...	• Performanca (vlerësimi) kriteri ...
• Performanca (vlerësimi) kriteri ...	• Performanca (vlerësimi) kriteri ...
• Performanca (vlerësimi) kriteri ...	• Performanca (vlerësimi) kriteri ...
Mori (konditash, pajisjeshmjetesh etj.), njohurish, shkathtësish, qëndrimesh	Mori (konditash, pajisjeshmjetesh etj.), njohurish, shkathtësish, qëndrimesh
Strategjia e vlerësimit	Strategjia e vlerësimit
• Dëshmitë e nevojshme (format e dëshmive, sasitë e dëshmive)	• Dëshmitë e nevojshme (format e dëshmive, sasitë e dëshmive)
• Metodat e vlerësimit	• Metodat e vlerësimit

Formati për modulet e kualifikimeve

Kualifikimet formale dhe jo-formale të AAP-së janë të përgatitura në kuadër të një kornize të përcaktuar, e cila përfshin qëllimin e kualifikimit; grupin e synuar; kompetencat e përgjithshme dhe profesionale që do të arrihen pas përfundimit; përmbajtjen e kualifikimit për module; pikët e caktuara të kredive dhe numrin e orëve për modul; opsionet e kalimit në nivele të mëtejshme të arsimit dhe punësimit; diplomat dhe certifikatat e fituara në fund të studimeve.

Zbatimi i kualifikimeve formale të AAP-së është i rregulluar me legjislacionin sekondar dhe kjo përcakton si në vijim: strukturën e AAP; grupin e synuar dhe kompetencat në përputhje me nivelet e KKK-së.

Një nga objektivat e KKK-së është të lehtësojë akumulimin dhe transferimin e rezultateve e të nxënit në mes të konteksteve të ndryshme, apo sistemeve e të nxënit- kjo përfshin të nxënit në sektorët formal dhe jo-formal të aftësim. AKK-ja ka zhvilluar një sistem të kredive të AAP, bazuar në rekomandimet ECVET. Qëllim i tij është të mbështesë lëvizshmërinë gjeografike dhe profesionale të nxënësve, duke u mundësuar atyre grumbullimin dhe kombinimin e rezultateve e të mësuarit nga mjedise të ndryshme dhe përdorimin e tyre në rrugë të ndryshme arsimore.

Sistemi i kredive i AKK-së përdor rezultatet e të nxënit, kategorizon kualifikimet duke matur vëllimin e të nxënit dhe identifikon ofruesit që kanë një rol dhe përgjegjësi në caktimin e kredive.

Në Kosovë 1 kredi është dhënë për 10 orë mësimore (Ky parim është zgjedhur, sepse mundëson që kreditë të jepen për rezultatet e të nxënit të fituara në periudha shumë të shkurtra kohore (p.sh. programe një ose dy ditore të aftësimit). Gjithashtu ofron shndërrimin relativisht të lehtë të pikëve ECTS (2.5 CVETS pikë = 1ECTS pikë).

AKK-ja rregullon sistemin e kredive nëpërmjet akreditimit të ofruesve dhe duke përcaktuar kriteret për caktimin se cilët ofrues mund të dorëzojnë kualifikimet për përfshirje në KKK. Këto kritere përfshijnë procedura strikte për caktimin e kredive, të cilat sigurojnë se ofruesit kanë kapacitetin dhe ekspertizën e nevojshme. KKK-ja gjithashtu siguron bazën për bashkëpunim dhe njohjen reciproke të kualifikimeve të AAP-së me vendet e tjera.

Validimi i të nxënit jo-formal dhe informal

Validimi i të nxënit jo-formal dhe informal është përcaktuar me Ligjin për Kualifikimet Kombëtare si

proces i vlerësimit të njohurive dhe shkathtësive, të cilat një individ i ka arritur më parë përmes fushave të ndryshme të të nxënit. AKK-ja ka zhvilluar një dokument politikash dhe udhëzimesh për validimin e të nxënit jo-formal dhe informal. AKK-ja ka zhvilluar edhe një Udhëzimin Administrativ për njohjen e mësimit paraprak; ky legjislacion përcakton parimet e përgjithshme, përgjegjësitë dhe procedurat për validimin e nxënit jo-formal dhe informal, në kuadër të KKK-së. AKK-ja do të akreditojë ofruesit për validimin e të nxënit jo-formal dhe informal.

Sistemi i arsimit të lartë

Aplikimi i rezultateve e të nxënit në arsimin e lartë është siguruar me akreditimin e institucioneve dhe programeve të arsimit të lartë (shih seksionin 2.3 dhe 2.5). Në arsimin e lartë përdoren ECTS kreditë. Numri i paraparë i kredive për një vit akademik të studimeve me orar të plotë është 60 kredi. Ngarkesa për një vit akademik të studimeve me orar të plotë është llogaritur 1.500 orë teorike për studentë, ndërsa 1 ECTS pikë kredi përfaqëson 25 orë teorike.

Aktualisht, nuk ka asnjë mekanizëm për validimin e të nxënit jo-formal dhe informal. Por, është duke u hartuar një UA, i cili do të vendos themelet për validimin e bazuar në parimet e udhëzimeve evropiane të validimit e të nxënit jo-formal dhe informal dhe për akreditimin e institucionit që do të kryejë këtë proces nga Agjencia e Kosovës për Akreditim.

Kriteri 4: Procedurat për përfshirjen e kualifikimeve në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve ose për përshkrimin e pozitës së kualifikimeve në sistemin kombëtar të kualifikimit janë transparente.

Arsimi i përgjithshëm

Kualifikimet në arsimin e përgjithshëm jepen në fund të programit mësimor nga ana e MASHT-it. Këto kualifikime janë zhvilluar dhe cilësia sigurohet nga Departamenti i Arsimit Parauniversitar i MASHT-it, bazuar në standardet kombëtare për kualifikimet dhe fushat e tyre kurrikulare. Si të tilla, ato janë automatikisht pjesë e KKK-së.

Struktura formale e arsimit është e bazuar në programin e arsimit, shumica e të cilave çon në rezultate të prekshme, të përcaktuara në drejtim të standardeve të pranuara kombëtare.

Niveli 1: Arsimi fillor është pjesë e arsimit të detyrueshëm dhe zgjat pesë vite (klasat 1-5). Në fund të klasës së pestë (5) nxënësit i nënshtrohen një provimi kombëtar të arritjeve dhe u jepet certifikata dalëse.

Niveli 2: Arsimi i mesëm i ulët është po ashtu pjesë e arsimit të detyrueshëm dhe zgjat katër vite (klasat 6-9). Në mënyrë që të përfundojnë arsimin e mesëm të ulët (klasat 6-9), nxënësit duhet të kalojnë provimin kombëtar, ose gjysmë-maturën dhe u jepet certifikata dalëse. Bazuar në rezultatet e arritura nxënësit mund të vazhdojnë arsimimin e tyre të mëtejshëm në AAP, ose arsim të përgjithshëm. Certifikata dalëse e arsimit të mesëm të ulët është e nivelit 3 të KKK-së.

Niveli 3: Arsimi i mesëm i lartë përbëhet nga lloje të ndryshme të gjimnazeve (klasat 10-12), i cili përfundon me provimin kombëtar të maturës. Nxënësit pas përfundimit të klasës së dymbëdhjetë (12) mund të vazhdojnë me arsimimin post-sekondar. Nxënësit, të cilët e kalojnë provimin kombëtar të maturës marrin diplomë dalëse dhe mund të vazhdojnë në arsimin e lartë. Diploma e Maturës është në nivelin 4 të KKK-së.

Sistemi i AAP-së dhe arsimi dhe aftësimi për të rritur

Kualifikimet e AAP-së janë të vendosura në KKK nëpërmjet një mekanizmi të zhvilluar dhe menaxhuar nga AKK-ja. Ai përbëhet nga procedurat për validimin dhe miratimin e kualifikimeve për përfshirje në

nivelet e përcaktuara të kornizës dhe kritereve, si dhe proceseve për akreditimin e ofruesve që ofrojnë këto kualifikime.

Procesi i validimit, i cili është i përcaktuar në ligj, është transparent dhe përbëhet nga katër faza: në fazën e parë, institucioni i cili kërkon validimin e një kualifikimi/moduli bën një kërkesë, e cila qartë paraqet arsyetimin për kualifikimin/modulin; në fazën e dytë, një panel i emëruar i ekspertëve i mbështetur nga AKK-ja e vlerëson kërkesën; në fazën e tretë raporti dhe rekomandimet e ekspertëve i paraqiten Këshillit Drejtues të AKK-së për vendimin përfundimtar; dhe në fazën e katërt, kualifikimi/moduli i miratuar vendoset në KKK dhe publikohet.

Kualifikimet, ose modulet të cilat propozohen për validim duhet të cekin si vijon:

1. Arsyeshmërinë nën këtë kriter kualifikimet profesionale, ose modulet e propozuara për validimin duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme: të kanë një arsyetim të qartë të qëllimit; objektivat; rrugët e progresionit në punësim ose arsim dhe aftësim të mëtutjeshëm, si dhe mbështetjen transparente të akterëve kryesorë; përmbushjen e nevojave të një sektori përkatës dhe mbështetjen e sektorit; ndërlidhjen me një profil të plotë të profesionit ose me arsim, trajnim apo nevojën për zhvillim;Credit value and duration;
2. Vlerën dhe kohëzgjatjen e kredive;
3. Kërkesat për hyrje dhe qasje;
4. Nivelin e propozuar të kualifikimit/modulit në AKK;
5. Përmbajtjen, rezultatet dhe standardet. Brenda kësaj gjenden nën-kritere specifike për arsimin profesional, të cilat përfshijnë: përmbajtjen profesionale të kualifikimit ose modulit që duhet të rrjedhë nga analizat e profesionit; strukturën e kualifikimit që duhet të jetë modulare dhe të bazohet në një ose më shumë module; modulet duhet të shprehin rezultatet e të nxënit në mënyrë të qartë dhe të vlerësueshme; rezultatet e të nxënit normalisht duhet të reflektojnë standardet e profesionit dhe duhet të përfshijnë kritere relevante dhe objektive të vlerësimit;
6. Vlerësimin. Një kualifikim ose modul duhet të përfshijë strategjinë e vlerësimit për vlerësimin e njohurive, shkathtësive dhe kompetencave;
7. Aranzhimet e sigurimit të cilësisë. Kjo përfshin vetë-vlerësimin dhe monitorimin e institucionit, përfshirë të dhënat e kandidatëve për përmbushje të kërkesave për sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë së proceseve të vlerësimit dhe certifikimit dhe për të siguruar prova të verifikueshme për arritjet e kandidatëve;
8. Progresioni. Kualifikimet duhet t'i mundësojnë nxënësit që ata të përparojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në punësim, ose mundësi të mëtutjeshme të të mësuarit në kuadër të punësimit.

Vendimet për nivelin në të cilin vendoset një kualifikim në kornizë merren në bazë të përputhjes së tyre me Përshkruesit e Nivelit, të cilët kanë të bëjnë me përshkruesit e KKK-së dhe treguesit e nivelit që përshkruajnë llojin e dispozitës formale dhe jo-formale, e cila do të çojë në kualifikimet në KKK.
Pas validimit të kualifikimit dhe vendosjes së tyre në KKK, vendimi publikohet në ueb-faqen e AKK-së.

Arsimi i lartë

Agjencia e Kosovës për Akreditim është institucioni përgjegjës për zbatimin e përshkruesve të KKK-së në arsimin e lartë në Kosovë. Zbatimi i KKK-së në këtë nivel sigurohet përmes procesit të akreditimit, procesi dhe kriteret janë të rregulluara nga një kornizë ligjore funksionale dhe janë të publikuara në faqen e internetit të Agjencisë.

Procesi i akreditimit kryhet në nivel të institucionit të arsimit të lartë dhe në nivel të programeve të ofruara nga institucionet. Kriteret për vlerësimin dhe procedurat për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë janë si më poshtë:

1. Fushëveprimi dhe numri i programeve, të cilat duhet t'i ofrojnë institucionet e llojeve të ndryshme në mënyrë që të kenë të drejtën e aplikimit për akreditim,si lloj i veçantë i institucioneve të

arsimit të lartë.

2. Për shkallë akademike sikurse institucionet e tjera në Fushën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA); krahasueshmëria e studimeve dhe rezultateve të përgjithshme të arsimit me institucione të ngjashme në EHEA.
3. Disponueshmëria, e demonstruar përmes kontratave detyruese ligjore e personelit të kualifikuar për të përmbushur standardet ndërkombëtare shkencore, artistike dhe profesionale.
4. Objekti, përfshirë hapësirën adekuate dhe pajisjet (p.sh. kompjuterët, bibliotekën, etj).
5. Liria akademike në hulumtim dhe mësimdhënie.
6. Hulumtimi i bërë në institucion dhe kontributi i tij për mësimdhënie.
7. Politikat dhe procedurat e brendshme për sigurimin e cilësisë së programeve të tyre të studimit dhe titujt.
8. Kriteret e pranimit dhe planet studimore (Kurrikulat e detajuara) dhe Rregulloret e provimeve.

Pas akreditimit të programeve dhe institucioneve, vendimi publikohet në faqen e internetit të AAK-së.

Kriteri 5: Sistemi(et) kombëtar i sigurimit të cilësisë për arsim dhe aftësim i referohet Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, ose sistemit dhe janë në përputhje me parimet dhe udhëzimet përkatëse evropiane.

Arsimi i përgjithshëm

KKK-ja është në përputhje me Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara dhe të Iniciativës së UNESCO-s -Arsim për të Gjithë. Ajo ka për qëllim të ofrojë qasje të barabartë në arsim cilësor për të gjithë nxënësit, pavarësisht nga përkatësia e tyre gjinore, etnike, mosha, kualifikimi social dhe ekonomik, raca, kultura, gjuha dhe besimi. KKK-ja është zhvilluar në përputhje me standardet e cilësisë (në kuptim të përmbajtjes dhe arritjeve të nxënësve). Ajo përputhet me kriteret e cilësisë si rëndësia, ndërlidhja, baraspesha, koherenca dhe progresioni domethënës i të mësuarit në përputhje me Kornizën Referuese Evropiane - Kompetencat kryesore për të mësuarit gjatë gjithë jetës. Duhet të theksohet se këto aplikohen në tërë Kurrikulën shkollore, përfshirë programet e arsimit të përgjithshëm.

Rezultatet e të nxënit të KKK-së për nivelet e arsimit të përgjithshëm janë të integruara në përshkruesit e nivelit të KKK-së dhe të përshtatura në kuadër të konceptit të KEK-së në lidhje me arritjen e kompetencave kryesore.

Në bazë të KKK-së, vlerësimi në nivel klase përfshin vlerësimin formativ gjatë gjithë vitit shkollor, vlerësim përfundimtar (pas përfundimit të vitit shkollor) dhe vlerësimin të përgjithshëm (pas përfundimit të një faze kyçe të Kurrikulës).

Zyra për Standarde dhe Vlerësim në kuadër të MASHT-it është përgjegjëse për vlerësimin e cilësisë së provimit të maturës dhe provimeve të tjera të standardizuara.

Sistemi i AAP-së, arsimi dhe aftësimi për të rritur


KKK-ja e Kosovës siguron bazën për bashkëpunim dhe njohje reciproke të kualifikimeve të AAP-së në mes të Kosovës dhe vendeve të tjera. Fillimisht kjo arrihet duke siguruar pajtueshmëri me:

- Kornizën Evropiane të Kualifikimeve për të mësuarit gjatë gjithë jetës (EQF)
- Përshkruesit e niveleve të EQF
- Parimet e cilësisë për AAP, të bashkangjitur në KEK dhe kritereve relevante për referencimin e KKK me KEK.
- Sistemin Evropian të Kredive për Arsim dhe Aftësim Profesional (ECVET) dhe Sistemin

Evropian të Akumulimit dhe Transferimit të Kredive (ECTS)

- Kornizën Referuese Evropiane për Sigurimin e Cilësisë për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (EQAVET)
- Pakon e Dokumenteve EUROPASS për transparencën e diplomave, certifikatave dhe kompetencave.

Kosova ka miratuar Kornizën Kombëtare të Sigurimit të Cilësisë në AAP në përputhje me Kornizën Referuese Evropiane për Sigurimin e Cilësisë për Arsimin dhe Aftësimin Profesional (EQAVET) për të ndërtuar një sistem funksional të sigurimit të cilësisë për kualifikimet e AAP-së duke përmbushur nevojat e shoqërisë së Kosovës dhe standardet evropiane.



Përveç kësaj, Kosova ka statusin e vëzhguesit në EQAVET, komunitetin e praktikës, i cili e mbështet zbatimin e Rekomandimit të BE-së për Sigurimin e Cilësisë në AAP ("EQAVET").

Arsimi i Lartë

KKK-ja e Kosovës siguron bazën për bashkëpunim dhe njohje reciproke të kualifikimeve të arsimit të lartë në mes të Kosovës dhe vendeve të tjera. Fillimisht kjo po arrihet duke siguruar pajtueshmëri me:

- Kornizën Evropiane të Kualifikimeve për mësim gjatë gjithë jetës (KEK) dhe Kornizën për Kualifikime në Fushën Evropiane të Arsimit të Lartë (FQEHEA)
- Përshkruesit e niveleve të KEK dhe përshkruesit e Dublinit për arsimin e lartë
- Parimet e cilësisë për arsimin e lartë të bashkangjitur në KEK,si dhe kriterin relevant për referimin e KKK me KEK

- Sistemin Evropian të Akumulimit dhe Transferimit të Kredive (ECTS)
- "Standardet dhe Udhëzimet Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Fushën e Arsimit të Lartë" të zhvilluara nga Rrjeti Evropian për Sigurimin e Cilësisë në arsimin e lartë (ENQA)
- Pakoja e Dokumenteve EUROPASS për transparencën e diplomave, certifikatave dhe kompetencave

Vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm i institucioneve të arsimit të lartë bëhet në përputhje me Standardet dhe Udhëzimet Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Fushën e Arsimit të Lartë, nga ENQA.

Kur vlerësohen programet arsimore me qëllim të akreditimit, paneli i ekspertëve i emëruar nga AAK-ja vlerëson pajtueshmërinë e përmbajtjes dhe rezultatet e të mësuarit të programit me përshkruesit e nivelit të KKK-së. Gjithashtu, vlerësohet rëndësia e përmbajtjes së programeve mësimore dhe metodave të mësimdhënies dhe mësim-nxënies me qëllimet dhe objektivat e programeve, si dhe burimeve për ofrimin e programeve. Prandaj, vlerësimi do të sigurojë se përmbajtja dhe realizimi i programeve arsimore do t'iu mundësojë nxënësve të fitojnë njohurit, shkathtësitë dhe kompetencat përkatëse në nivelin përkatës të kualifikimit.

AKA-ja aktualisht është anëtare partnere e Shoqatës Evropiane për Sigurimin e Cilësisë (ENQA). Ajo ka përfunduar procesin e aplikimit për anëtarësim të plotë në ENQA dhe pret vendimit gjatë gjysmës së parë të vitit 2014. AKA-ja është anëtare e plotë e Rrjetit të Evropës Qendrore dhe Lindore të Agjencive për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (CEENQA) dhe Rrjetit Ndërkombëtar i Agjencive për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (INQAAHE).

Kriteri 6: Procesi i referencimit duhet të përfshijë marrëveshjen e deklaruar të organeve relevante të sigurimit të cilësisë

Të gjitha institucionet relevante të sigurimit të cilësisë janë angazhuar në mënyrë aktive në grupin punues për referencimin e KKK-së me KEK, si dhe në procesin e konsultimit:

- Agjencia Kosovare për Akreditim – institucion përgjegjës për sigurimin e cilësisë në sistemin e arsimit të lartë – dhe këshilli i saj drejtues, Këshilli Kombëtar i Cilësisë.
- AKK-ja – institucion që monitoron cilësinë e sistemit të AAP-së
- Inspektorati i Arsimit –organ për sigurimin e cilësisë për arsimin para-universitar në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.
- Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Divizioni për Aftësime Profesionale – përgjegjës për sigurimin e cilësisë në qendrat aftësuese të MPMS-së.
- Koordinatorët për Sigurimin e Cilësisë në qendrat e kompetencës dhe në disa shkolla të AAP-së.

Kriteri 7: Procesi i referencimit duhet të përfshijë ekspertët ndërkombëtar

Në procesin e referencimit, ekspertët ndërkombëtarë kanë qenë të përfshirë në shqyrtimin e draft-raportit të përgatitur nga tre ekspertë vendas. Komentet e ngritura nga ekspertët ndërkombëtarë janë adresuar nga ekspertët vendor dhe ka pasur një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet ekspertëve për përfundimin e raportit.

Ekspertët e angazhuar në procesin e referencimit janë

1. **John Hart, Skoci**

   JohnHart ka punuar si konsulent i arsimit dhe aftësimit që nga viti 2003. Puna e tij kryesore ka qenë në Turqi, Rumani, Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, por ai ka kontribuar edhe për zhvillimet në botë si në Egjipt, Poloni dhe Kazakistan.

   Ai është aktualisht duke punuar në zhvillimin e llojeve të kualifikimit në Kosovë dhe

në zbatimin e Kornizës Kombëtare të Shkathtësive dhe Kualifikimeve në Indi. Ai është gjithashtu duke asistuar UNESCO në hetimin e mundësisë së zhvillimit të niveleve botërore të referencimit. Fokusi kryesor i punës së tij ka qenë në zhvillimin dhe themelimin e sistemeve të kualifikimit, sistemeve të sigurimit të cilësisë dhe Kornizave Kombëtare të Kualifikimeve dhe Kredive. Ai ka kontribuar në referencimin e Kornizave të Kualifikimit të Skocisë, Uellsit, Holandës dhe Maltës me KEK.

Ai është autor i *"Developing a National System of Vocational Qualification"*, në Manualin Ndërkombëtar të Arsimit për botën e punës të UNESCO-UNEVOC, si dhe *"NQF's as credit systems"*, të publikuara nga SAQA. Ai ka shkruar gjithashtu edhe një numër të dokumenteve të politikave dhe hulumtimit, duke përfshirë *"Recognising Achievement: Literature review and model for managing recognition processes"*(publikuar nga Qeveria e Skocisë), *"Unitisation – benefits and issues"* (publikuar Autoriteti i Kualifikimeve i Skocisë) dhe *Cross-referencing qualifications frameworks* (publikuar nga Universiteti i Edinburgut).

2. **Michael Graham, MB**

Michael Graham është një ekspert i kualifikimeve në Fondacionin Evropian të Trajnimit (ETF), një agjenci e BE-së e cila mbështet sistemet e AAP-së të vendeve fqinje të BE-së.

Ai është udhëheqës i ekipit në ETF. Ai iu bashkëngjit Fondacionit në vitin 2010, dhe ka punuar me çështjet e kualifikimeve me vendet partnere të ETF në vendet e Ballkanit, regjionet jugore mesdhetare. Ai gjithashtu ishte autor, apo kontribuues në disa publikime të Fondacionit.

Para se t'i bashkohet ETF, Michael ishte në Shërbimin Civil të MB, ku punoi në Departamente të ndryshme arsimore në kualifikime dhe kurrikula. Ai ishte i deleguar edhe nga Britania e Madhe për 3 vjet në DG EAC, Komisioni Evropian, ku ai ishte anëtar i ekipit i cili e zhvilloi KEK-në.

Gjatë përzgjedhjes së ekspertëve ndërkombëtar janë marrë në konsideratë kriteret në vijim:

- • Eksperienca e ekspertit në zhvillimin dhe prezantimin e KKK-së;
- • Eksperienca në zhvillimin e raporteve të referencimit dhe shqyrtimin e raportit të referencimit;
- • Njohuria e ekspertit në fushën e arsimit;
- • Njohuria e ekspertit në lidhje me sistemin arsimor në Kosovë.

Kriteri 8: Organi, ose organet kompetente kombëtare duhet të vërtetojnë edhe referencimin e Kornizës kombëtare, apo sistemit me KEK. Organet kompetente kombëtare, përfshirë Pikën Koordinuese Kombëtare, duhet të publikojnë një raport gjithëpërfshirës, i cili përcakton edhe referimin dhe provat mbështetëse, si dhe duhet të adresojë veçmas secilin kriter.

Ky raport i referencimit është përgatitur me të gjitha palët e interesuara relevante, përfshirë partnerët social. Ky raport do të publikohet dhe kopja e tij elektronike do të jetë në dispozicion në ueb-faqen e AKK-së (www.akk-ks.net),), në ueb-faqen e MASHT-it (www.masht-gov.net) dhe në ueb-faqen e AKA-së (www.akreditimi-ks.org).

Kriteri 9: Platforma zyrtare e KEK duhet të mirëmbajë një list publike të shteteve anëtare që e kanë konfirmuar se e kanë përfunduar procesin e referencimit, duke përfshirë lidhjet e raporteve të përfunduara të referencimit.

Raporti për procesin e referencimit të KKK-së së Kosovës do të përcillet në Ministrinë e Arsimit, e cila do të informojë Komisionin Evropian se procesi i referencimit ka përfunduar dhe se pret prezantimin në Grupin Këshillues të KEK.
Raporti do të publikohet në platformën zyrtare të KEK si dhe në web-faqen zyrtare të AKK www.akk-ks.net.

Kriteri 10: Pas procesit të referencimit, dhe në përputhje me afatet e përcaktuara në rekomandim, të gjitha certifikatat e reja të kualifikimit, diplomat dhe dokumentet e Europass, të lëshuara nga organet kompetente, përmbajnë një referencë të qartë, përmes sistemeve kombëtare të kualifikimeve, në nivelin e duhur të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve.

Sipas Ligjit për kualifikimet kombëtare, certifikatat dhe diplomat e kualifikimeve në KKK duhet të sigurojnë përputhshmërinë me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve.

Të gjitha diplomat dhe certifikatat e Kosovë në AAP dhe AL, përmendin nivelin e kualifikimit të KKK-së ose diplomën e fituar. Në AL lëshohet gjithmonë Shtojca e Diplomës. Për të gjitha kualifikimet në AAP janë në dispozicion Shtojca të Certifikatës. Është planifikuar hartimi i legjislacionit sekondar për shtojcën e diplomës në arsimin e përgjithshëm, pas raportit për referencimit me KEK.

Referencat

FET, 2012, Procesi i Torinos: Kosovë

BE, Korniza Evropiane e Kualifikimeve;

AKA, 2009, Udhëzimi Administrativ Nr. 2/2009, UA Nr. 25/2012 dhe UA Nr. 02/2013 mbi akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, Prishtinë;

AKA, 2012, Raportet vjetore, Prishtinë;

AKA, 2013, Raportet vjetore, Prishtinë;

MASHT,2011 Korniza e Kurrikulës së Kosovës, Prishtinë;

MASHT, 2011, Ligji për Kualifikimet Kombëtare, Prishtinë;

MASHT, 2011 Ligji mbi Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Prishtinë;

MASHT, 2011 Ligji mbi Arsimin dhe Aftësimin Profesional, Prishtinë;

MASHT, 2004, Ligji për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë, Prishtinë;

MASHT 2001, 2013 Ligji për Arsimin dhe Aftësimin e të Rriturve, Prishtinë;

MASHT, 2011, Ligji mbi Arsimin e Lartë në Kosovë, Prishtinë;

MASHT, 2011, Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2011-2016, Prishtinë;

MASHT,2011 Raportet vjetore, Prishtinë;

MASHT,2012 Raportet vjetore, Prishtinë;

MASHT,2013 Raportet vjetore, Prishtinë;

KKK, 2011, Korniza Kombëtare e Kualifikimeve, Prishtinë;

AKK, 2011, Udhëzimi Administrativ Nr. 01/ 2011 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikimin në Kosovë, Prishtinë;

AKK, 2011, Raporti vjetor i AKK-së, Prishtinë;

AKK, 2012, Raporti vjetor i AKK-së, Prishtinë;

AKK, 2013, Raporti vjetor i AKK-së, Prishtinë;

AKK, 2011, Udhëzues për Zhvillimin e kualifikimeve modulare, Prishtinë;

AKK, 2011, Udhëzues për vlerësimin dhe certifikimin në KKK, udhëzues praktik “Pako e veglave”, Prishtinë;

AKK, 2011, Udhëzime për modifikimet dhe përshtatjet e nevojshme për zhvillimin e qasjes në programet dhe kualifikimet e arsimit dhe aftësimit profesional për nxënësit me aftësi të kufizuara apo me nevoja tjera të veçanta, Prishtinë;

AKK, 2011, Sigurimi i cilësisë në Institucionet e AAP-së, Udhëzues praktik për implementim;

AKK, 2011, Udhëzime për modifikimet dhe përshtatjet e nevojshme për zhvillimin e qasjes në programet dhe kualifikimet e arsimit dhe aftësimit profesional për nxënësit me aftësi të kufizuara apo me nevoja tjera të veçanta, Prishtinë

Shtojcat

Shtojca 1: Angazhimi i palëve të interesuara në zhvillimin e raportit të referencimit

Nga arsimi i përgjithshëm:

Nr.	Emri dhe mbiemri	Pozita	Instituti	Fusha: Arsimi i përgjithshëm
1.	Elizabeta Haziri	Menaxhere e projektit	Qendra Evropiane për Çështje të Pakicave	Arsimi i RAE
2.	Radica Berishaj	Zyrtare	MASHT	Të mësuarit gjatë gjithë jetës
3.	Agron Hajdari	Mësues	APPK	Institucioni Privat i Arsimit
4.	Florie Rrecaj	Mësuese	Shkolla fillore "Faik Konica"	Arsimi fillor
5.	Aferdita Jaha		MASHT	
6.	Lulavere Behluli	Zyrtare	MASHT	Arsimi i nxënësve me nevoja të veçanta
7.	Driton Bajraktari	Menaxher i projektit	"Down Syndrome Kosovo"	Arsimi i nxënësve me nevoja të veçanta
8.	Hajdar Shyti	Drejtor i shkollës		
9.	Rexhep Kastrati	Zyrtar	MASHT	Korniza e Kurrikulës
10.	Miranda Kasneci	Zyrtar	MASHT	Arsimi i përgjithshëm

Nga AAP dhe arsimi dhe aftësimi për të rritur

a) Pjesëmarrësit në punëtori

Nr.	Emri dhe mbiemri	Pozita	Instituti	Fusha: AAP dhe aftësimi për të rritur
1	Ragip Gjoshi	Këshilltar i ministrit	MASHT	Arsim
2	Radica Berisha	Zyrtare e arsimit dhe aftësimit për të rritur	MASHT	AAP dhe aftësimi për të rritur
3	Sophie Beaumont	Përfaqësuese dhe përgjegjëse për komponen-tën e arsimit në Zyrën e BE-së	Zyra e BE-së në Kosovë	Arsim
4	Isuf Calaj		Shkolla profesionale Ferizaj	AAP dhe aftësimi për të rritur
5	Fatmire Salihu		Qendra e aftësimit e MPMS-së: Ferizaj	AAP dhe aftësimi për të rritur
6	Burhan Selmani		Qendra e aftësimit e MPMS-së: Gjilan	AAP dhe aftësimi për të rritur
7	Sinan Gashi		Qendra e aftësimit e MPMS-së: Prizren	AAP dhe aftësimi për të rritur

8	Zenjullah Rrustemi		Qendra e aftësimit e MPMS-së: Prishtina	AAP dhe aftësimi për të rritur
9	Hajrije Shaipi	Drejtoreshë	Shkolla profesionale: Prishtinë	AAP dhe aftësimi për të rritur
10	Majlinda Bajraktari		Projekti EYE financuar nga Agjencia zvicerane për bashkëpunim	AAP dhe aftësimi për të rritur
11	Xhelal Susuri	Drejtor	Shkolla profesionale: Gjakovë	AAP dhe aftësimi për të rritur
12	Tom Frrokaj		Shkolla profesionale: Gjakovë	AAP dhe aftësimi për të rritur
13	Binak Morina		Projekti i GIZ-it për shkollën profesionale	AAP dhe aftësimi për të rritur
14	Avni Gashi	Ekspert për Sigurimin e Cilësisë (SC)	AKK	AAP dhe aftësimi për të rritur
15	Milot Hasangjekaj	Ekspert për kualifikime	AKK	AAP dhe aftësimi për të rritur
16	Ahmet Mustafa		Qendra e aftësimit e MPMS-së: Mitrovicë	AAP dhe aftësimi për të rritur
17	Rexhe Gashi		Qendra e aftësimit e MPMS-së: Pejë	AAP dhe aftësimi për të rritur
18	Anton Gojani		Shkolla private profesionale: Prishtina	AAP dhe aftësimi për të rritur
19	Rame Likaj		Konsulent në projektet e KOSVET	AAP dhe aftësimi për të rritur
20	Ejup Zariqi		DKA Ferizaj	AAP dhe aftësimi për të rritur
21	Bleta Kadriu		AKK	AAP dhe aftësimi për të rritur
22	Donjeta Nimani		AKK	AAP dhe aftësimi për të rritur
23	Kaltrina Mulliqi		AKK	AAP dhe aftësimi për të rritur
24	Ardiana Gashi	Konsulent vendor		AAP dhe aftësimi për të rritur
25	Blerim Haliti		LuxDevelopment	AAP dhe aftësimi për të rritur
26	Besim Mustafa	Udhëheqës i departamentit të APP-së	Oda ekonomike e Kosovës	AAP dhe aftësimi për të rritur

b) Lista e intervistave

Nr.	Emri dhe mbiemri	Pozita	Instituti
1	Avni Gashi	Ekspert për SC	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
2	Aferdita Jaha	Zyrtare për arsim jo-formal	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë

3	Avni Rexha	Udhëheqës i Zyrës për Barasvlerë dhe njohje të arsimit AAP	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
4	Ryve Prekorogja	Udhëheqëse e Divizionit të AAP	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
5	Jehona Namani	Udhëheqëse e Divizionit për aftësim profesional	Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale
6	Gani Ismajli	Zyrtar i lartë për Sigurimin e Cilësisë dhe Certifikim	Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale
7	Liridona Ajeti	Zyrtare e lartë për projekte dhe programe	Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale
8	Blerim Haliti		LuxDevelopment

Nga arsimi i lartë

a) Pjesëmarrësit në punëtori

Nr.	Emri dhe mbiemri	Pozita	Instituti	Fusha: Arsimi i lartë
1	Bujar Gallopeni	Udhëheqës i Qendrës për bashkëpunim ndërkombëtar në arsimin e lartë dhe teknologji	MASHT	Arsimi i lartë
2	Bardha Qirezi	Zyrtare për arsim dhe aftësim për të rritur	Kolegji Riinvest	Arsimi i lartë
3	Blerina Gjinolli		Universiteti i Prishtinës	Arsimi i lartë
4	Dugagjin Sokoli		Universi	Arsimi i lartë
5	Valbona Uka		Tempulli	Arsimi i lartë
6	Bekim Marmullaku		Fama	Arsimi i lartë
7	Shpresa Mehmeti		MASHT	Arsimi i lartë
8	Kimete Canaj		TEMPUS	Arsimi i lartë
9	Luljeta Aliu		WUS Kosova	Arsimi i lartë
10	Etleva Blakaj		WUS Austria	Arsimi i lartë
11	Xhavit Rexhaj	Drejtor	WUS Austria dhe AAB	Arsimi i lartë
12	Kumrije Gagica		MASHT	Arsimi i lartë
13	Vlera Limani		Pjetër Budi	Arsimi i lartë
14	Donika Berisha		Këshilli Britanik	
15	Milot Hasangjekaj		AKK	
16	Teuta Danuza		AKK	
17	Donjeta Nimani		AKK	

18	Bleta Kadriu		AKK	
19	Kaltrina Mulliqi		AKK	
20	Merita Fehmiu		WUS Austria	
21	Artane Rizvanolli		Riinvest	
22	Furtuna Memhedi		AKA	

b) Lista e intervistave

No.	Name	Position	Institution
1	Ferdije Zhushi	Udhëheqëse	Këshilli Kombëtar i Cilësisë
2	Bujar Gallopeni	Udhëheqës	Qendra për bashkëpunim ndërkombëtar në arsim të lartë dhe teknologji (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë)

Shtojca 2: Modeli i Shtojcës së Diplomës për arsimin e lartë

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

SHTOJCA E DIPLOMËS

Kjo Shtojcë e Diplomës është hartuar në bazë të modelit të hartuar nga Komisioni Evropian, Këshilli i Evropës dhe UNESCO/CEPES. Qëllimi i shtojcës është që të sigurojë të dhëna të pavarura dhe të mjaftueshme për përmirësimin e "transparencës" ndërkombëtare, si dhe njohjes së paanshme akademike dhe profesionale të kualifikimeve (diplomave, titujve shkencorë, certifikatave, etj). Është dizajnuar ashtu që të ofroj përshkrimin e natyrës, nivelit, kontekstit, përmbajtjes dhe statusit, të ndjekur dhe kryer me sukses nga individi, i emëruar në kualifikimin origjinal, për të cilin edhe është bashkëngjitur kjo Shtojcë. Duhet të jetë e lirë nga gjykimet mbi vlerën, deklaratat e barasvlershme apo sugjerimet për njohjen. Duhet të jepen informacione në të gjithë tetë sektorët. Aty ku informacionet nuk jepen, duhet të sqarohet arsyeja pse.

1. **INFORMACIONET IDENTIFIKUESE TË OFRUESVE TË KUALIFIKIMEVE**	
1.1 Mbiemri (mbiemrat):	
1.2 Emri (emrat):	
1.3 Data e lindjes (dita/muaji/viti):	
1.4 Numri identifikues (dosja e) i studentit (nëse është në dispozicion)	
2. INFORMACIONET IDENTIFIKUESE PËR KUALIFIKIMIN E FITUAR	
2.1 Titulli i kualifikimit dhe *(nëse aplikohet)* titulli i dhënë *(në gjuhën origjinale)*	
2.2. Fusha(t) kryesore të studimit për kualifikim	
2.3 Emri dhe statusi i institutit që e lëshon kualifikimin *(në gjuhën origjinale)*	
2.4 Emri dhe statusi i institutit *(nëse ndryshon nga 2.3)* që administron studimet *(në gjuhën origjinale)*:	
2.5 Gjuha (gjuhët) gjatë mësimit/provimit	
3. **INFORMACIONET PËR NIVELIN E KUALIFIKIMIT TË FITUAR**	
3.1 Niveli i kualifikimit	

3.2 Kohëzgjatja zyrtare e programit	
3.3 Kushti (kushtet) për pranim	
4. INFORMACIONE MBI PËRMBAJTJEN DHE REZULTATET E ARRITURA	
4.1 Mënyra e studimit	
4.2 Kërkesat e programit	
4.3 Detajet rreth programit: (p.sh. modulet apo njësitë e ndjekura), si dhe shkallët/ notat/ kreditë e arritura: *(nëse ekzistojnë këto informata, atëherë t'i bashkëngjitet edhe pasqyra zyrtare e notave)* **Gjeni të bashkëngjitur transkriptin (pasqyrën) e notave**	

4.4 Skema e notimit si dhe, nëse ekziston, udhëzimi për përshkrimin e notave

Nota	Përshkrimi	Përqindja e diturisë	Nota ekuivalent me ECTS
10	Shkëlqyeshëm	90-100	A
9	Shumë mirë	80-89	B
8	Mirë	70-79	C
7	Mjaftueshëm	60-69	D
6	Kaluese	50-59	E
5	Dobët	0-49	FX/F

4.5. Klasifikimi i përgjithshëm i kualifikimit *(në gjuhën origjinale)*:	Sistemi i vlerësimit është bazuar në sistemin kombëtar të vlerësimit dhe sistemit ECTS
5. INFORMACIONE PËR FUNKSIONIN E KUALIFIKIMIT	
5.1. Pranimi në studime të mëtejme	Kualifikimi mundëson vazhdimin e mëtutjeshëm në studime master
5.2 Statusi profesional *(sipas nevojës)*:	
6. INFORMACIONE SHTESË	
6.1 Informacione shtesë	
6.2 Burime shtesë për informacione:	
7. CERTIFIKIMI I SHTOJCËS	
7.1 Data:	
7.2 Nënshkrimi:	
7.3 Aftësia:	
7.4 Vula zyrtare:	

8. INFORMACIONE PËR SISTEMIN KOMBËTAR TË ARSIMIT TË LARTË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

8.1 Sipas Ligjit (nr. 04/L-037) për Arsimin e Lartë, arsim i lartë në Republikën e Kosovës konsiderohet çdo arsimim pas shkollës së mesme të lartë (Ligji nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar), në nivelet 5, 6, 7 dhe 8 të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve për të mësuarit gjatë gjithë jetës, për të cilin mund të jepen kredi (ECTS). Në përputhje me Procesin e Bolonjës, arsimi i lartë në Republikën e Kosovës organizohet në tri cikle: Baçelor, Master dhe Doktoratë.

8.2 Kualifikimet e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, mund të jenë akademike apo profesionale dhe mund të lëshohen nga institucionet (ofruesit) e arsimit të lartë siç janë "Universitetet", "Kolegjet Universitare", "Kolegjet", "Institutet", "Shkollat" ose "Akademitë". Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Ligjin për Kualifikimet Kombëtare, akreditimin e programeve dhe institucioneve që ofrojnë kualifikime në arsim të lartë e bën Agjencia e Kosovës për Akreditim – AKA.

8.3 Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, si publike ashtu edhe ato private, përdorin Sistemin evropian për mbledhje dhe transfer të kredive (ECTS – European Credit Accumulationand Transfer System). Në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, puna vjetore e një studenti të rregullt llogaritet të jetë 1.500 orë, duke bërë që një ECTS kredi të jetë e barabartë me 25 orë të mësimit të planifikuar.

Për më shumë informata vizitoni:

www.masht-gov.net; www.akreditimi-ks.org; www.akk-ks.net

Shtojca 3: Kushtet për akreditim në arsimin e lartë

1. FORMA LIGJORE DHE LOKACIONI

Institucioni që aplikon duhet të jetë person juridik, i vendosur në Kosovë.

2. OFERTAT E STUDIMIT

Orari i programeve studimore duhet të dorëzohet së bashku me aplikacionin:

- Universiteti duhet të ofroj lëndë, apo programe të akredituara për së paku katër vjet, në të paktën pesë fusha të ndryshme studimore që kanë lëshuar të paktën një diplomë në nivel doktorate të akreditуar në secilin nga këto programe.
- Kolegji Universitar duhet ofroj lëndë, apo programe të akredituara në së paku tri fusha të ndryshme studimore me të paktën një program të akreditуar studimor në nivel të doktoratës në secilën prej këtyre fushave studimore.
- Kolegji duhet të jap lëndë, apo programe të akredituara në të paktën një fushë studimi për të paktën një cikël.
- Këto programe studimore duhet të përfundojnë me diplomë akademike, e cila përmbush standardet ndërkombëtare dhe i është dhënë për studimet e rregullta,
- Këto programe studimore duhet të jepen në një, ose disa disiplina shkencore, akademike, ose profesionale,
- Ose duhet të ketë studime që mund të zgjerohen pasi që studimet tjera akademike të kenë përfunduar (specializimet).

3. KRAHASUESHMËRIA E STUDIMEVE

Nëse Institucioni i Arsimit të Lartë që aplikon, dëshiron që të jap tituj akademik si institucionet e tjera në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA), atëherë studimet dhe rezultatet e përgjithshme arsimore në institucionin që aplikon, duhet të jenë të krahasueshme me ato të institucioneve të ngjashme në EHEA.

4. PERSONELI MËSIMOR

Kualifikimet e personelit mësimor në institucionet e arsimit të lartë duhet të përmbushin standardet ndërkombëtare shkencore, artistike dhe profesionale. Kontratat që ligjërisht obligojnë këtë personel duhet të dorëzohen së bashku me aplikacionin. Këto kontrata duhet të tregojnë përshtatshmërinë e personelit për studimet e planifikuara të institucionit.

5. OBJEKTET

Institucioni që aplikon duhet të ketë në dispozicion personel, hapësirë dhe pajisje të mjaftueshme (p.sh. kompjuterë, bibliotekë, etj) për studime efikase. Këto duhet të sigurohen në përputhje me llojin e institucionit arsimor.

Dëshmia për personelin mësimor dhe mbështetës, hapësirën dhe pajisjet duhet ta shoqëroj aplikacionin.

6. PARIMET

Një institucion i arsimit të lartë duhet t'i orientojë aktivitetet e veta në përputhje me parimet e

mëposhtme:

- Liria e shkencës dhe mësimdhënies;
- Liria e aktiviteteve artistike, e shprehjes artistike dhe mësimdhënien e saj;
- Lidhjet ndërmjet hulumtimit dhe mësimdhënies;
- Diversiteti i teorive artistike, metodave dhe ideve të mësimdhënies;

7. EMËRTIMI I INSTITUCIONIT

LAL thekson kur një institucion arsimor ka të drejtë ta quaj veten "Universitet". Fjala "Universitet", si fjalë e veçantë ose në kombinim me përshkrime tjera, nuk mund të miratohet ose të përdoret në asnjë formë në emërtimin e ndonjë ofruesi shërbimesh pa lejen e Ministrisë, pas miratimit në parim nga ana e AKA-së.

Titujt akademikë të institucioneve të akredituara private të arsimit të lartë kanë vlerën e njëjtë ligjore si të atyre të institucioneve publike.

Academic degrees of accredited private institutions of higher education have the same legal value as those of public institutions.

8. KRITERET BAZË

8.1 Liria Akademike

Institucionet e arsimit të lartë duhet të jetë autonome dhe duhet të garantojnë lirinë akademike. Statutet e tyre dhe strukturat organizative duhet të sigurojë lirinë në hulumtim (si për paraqitje të pyetjeve, teorive dhe metodave ashtu edhe në shpërndarjen e rezultateve të kërkimit dhe vlerësimit të tyre) dhe lirinë e mësimdhënies (sa i përket diversitetit të përmbajtjes, metodave të ligjërimit të lëndës dhe lirisë së të shprehurit të mendimeve shkencore dhe artistike).

8.2 Fushëveprimi dhe diversiteti

Institucioni duhet të ketë gamë të gjerë dhe të larmishme të studimeve brenda një ose më shumë disiplinave, të cilat përputhen me konceptin evropian për arsimin e lartë. Disiplinat mund të përfshijnë fushat tradicionale p.sh. mjekësinë, muzikën, drejtësinë apo teologjinë, si dhe kurse të tjera të reja të kombinuara me shkallë të lartë të krahasueshmërisë.

8.3 Hulumtimi në institucion

Hulumtimi duhet të kryhet në institucion. Kjo përcakton praninë e një mase kritike për prodhimin e institucionalizuar të dijes dhe kontributin e saj në mësimdhënie.

8.4 Personeli mësimor

Institucioni duhet të ketë në dispozicion personel të përhershëm të mjaftueshëm akademik, shkencor dhe artistik, me kontrata të punësimit me orar të plotë që janë të vlefshme për të paktën tre vjet. Ky personel i përhershëm arsimor duhet të jetë i kualifikuar ose i shquar në arte, dhe duhet të mbulojë të paktën 50% e gjithë punës mësimore të një lënde mësimore, si dhe duhet të jetë i kualifikuar (doktoratë ose arritje artistike). Për të siguruar lidhjen midis hulumtimit dhe mësimdhënies, ky personel i përhershëm mësimor duhet të ketë të paktën tre persona për çdo program studimi, dhe të paktën njëri prej tyre duhet të ketë statusin e profesorit. Ky person duhet të ketë kualifikimin më të lartë shkencor ose artistik.

8.5 Procedurat për përzgjedhjen e personelit mësimor

Procedura e institucionit për përzgjedhjen e gjithë personelit akademik duhet të jetë transparente, konkurruese dhe të bëhet përcaktimi sipas cilësisë.

8.6 Sigurimi i cilësisë

Institucionet duhet të kenë të vendosura politikat dhe procedurat interne për sigurimin e cilësisë së programeve të tyre të studimit dhe diplomave.

8.7 Planet e studimit

Planet e studimit (Kurrikulat e detajuara) dhe rregullat e provimit duhet të përmbushin të gjitha kërkesat materiale, profesionale dhe formale, dhe atë sipas standardeve ndërkombëtare. Regjistrimi në studime duhet të korrespondojë me rregullat e Kosovës dhe kushtet e përgjithshme për pranim në arsimin e lartë.

8.8 Objektet dhe pajisjet

Objektet dhe pajisjet duhet të sigurojë mjete të mjaftueshme për studim në përputhje me standardet ndërkombëtare.

8.9 Financimi

Përkrahja për financimin afatmesëm të institucionit duhet të demonstrohet nëpërmjet një plani të detajuar biznesi.

8.10 Plani zhvillimor

Institucioni duhet të demonstrojë se si do të përmbushen të gjitha kërkesat e mësipërme në një plan zhvillimor që mbulon periudhën prej tre vjetësh.

Shtojca 4: Lista e institucioneve të akredituara, kualifikimet e miratuara, si dhe standardet e konfirmuara/verifikuara profesionale

Lista e institucioneve të akredituara dhe kualifikimet e aprovuara

Qendra Sociale Edukuese "Don Bosko"

- Asistent administrativ; niveli i KKK-së: (4)
- Saldues; niveli i KKK-së: (3)
- Instalues uji dhe kanalizimi; niveli i KKK-së: (3)
- Elektricist; niveli i KKK-së: (3)
- Instalues i ngrohjes qendrore; niveli i KKK-së (3)
- Teknologji informative, niveli i KKK-së (4-për shkollë)
- Teknologji informative, niveli i KKK-së (2- për QT)

Qendra rajonale për aftësim profesional - Gjakovë

- Asistent administrativ; niveli i KKK-së: (3)
- Saldues; niveli i KKK-së: (3)

Qendra rajonale për aftësimin profesional - Mitrovicë

- Saldues; niveli i KKK-së: (3)
- Teknologji informative, niveli i KKK-së (2)

Qendra rajonale për aftësimin profesional - Pejë

- Asistent administrativ; niveli i KKK-së: (3)
- Saldues; niveli i KKK-së: (3)
- Instalues uji dhe kanalizimi; niveli i KKK-së: (3)

Qendra rajonale për aftësim profesional - Prishtinë

- Asistent administrativ; niveli i KKK-së: (3)
- Instalues uji dhe kanalizimi; niveli i KKK-së: (3)
- Instalues i ngrohjes qendrore; niveli i KKK-së: (3)
- Teknologji informative, niveli i KKK-së (2)

Qendra rajonale për aftësim profesional - Ferizaj

- Saldues; niveli i KKK-së: (3)
- Instalues uji dhe kanalizimi; niveli i KKK-së: (3)
- Teknologji informative, niveli i KKK (2)

Qendra rajonale për aftësim profesional - Prizren

- Saldues; niveli i KKK-së: (3)
- Teknologji informative, niveli i KKK-së (2)

Qendra rajonale për aftësim profesional - Gjilan

- Saldues; niveli i KKK-së: (3)

Qendra për aftësim e “Korporatës Energjetike të Kosovës”

- Saldues; niveli i KKK-së: (4);
- Tornim; niveli i KKK-së: (3);
- Frezim; niveli i KKK-së: (3);
- Shpim; niveli i KKK-së: (3);
- Prerje; niveli i KKK-së: (3)
- Elektricist; niveli i KKK-së: (4)
- Teknologji informative, niveli i KKK-së (2)

Qendra për Arsim dhe Këshillim Profesional “Gjon Nikoll Kazazi” Gjakovë

- Asistent administrativ; niveli i KKK-së: (4)
- Teknologji informative, niveli i KKK-së (4)
- Qendra për Aftësim dhe Zhvillim “PTK”, Prishtinë
- Asistent administrativ; niveli i KKK-së: (3)
- Teknologji informative, niveli i KKK-së (3)

Lista e standardeve të verifikuara profesionale

Makineri: Automekanik; Metal-punues

Teknologji ushqimore: Bukëpjekës; Kasap; Punëtor bulmeti

Ndërtimtari: Instalues i ngrohjes qendrore; Elektricist; Instalues uji dhe kanalizimi

Bujqësi: Shitës; Teknik agrobiznesi; Furnizues

Ekonomi: Nëpunës banke; Nëpunës financiar; Nëpunës marketingu; Nëpunës në Zyrën e burimeve njerëzore; Nëpunës në zyrë administrimi dhe menaxhimi; Nëpunës për eksport dhe import; Nëpunës industrial

Tregti: Shitës me pakicë; Shitës me shumicë; Shitje dhe shërbim ndaj klientit

Turizmi: Planifikimi dhe menaxhimi i evenimenteve; Zyrtar në menaxhimin e turizmit; Planifikimi i shërbimit të informacionit të udhëtimit dhe turizmit

Shëndetësi: Teknik i syve (për syza); Teknik ortoprostetik; Teknik dentar; Teknik i farmacisë; Audiometrik; Asistent i ortopedisë; Asistent i shëndetësisë dhe kujdesit social; Asistent i të ushqyerit dhe sigurisë së ushqimit; Teknik i emergjencës; Zjarrfikës;

Shkenca shoqërore: Lidershipi dhe puna me të rinjtë në komunitet

Shtojca 5: Modeli i një standardi të profesionit

STANDARDET PROFESIONALE

TEKNIK I AUTOMJETEVE

FUSHA: INXHINIERI

Profesioni: Teknik i automjeteve (Automekanik)

Përshkrimi i profesionit:

Tekniku i automjeteve riparon, mirëmban, kontrollon, diagnostifikon dritat e automjetit. Gjen defektet, i riparon dhe ofron shërbime tjera në sisteme mekanike, elektrike, elektronike dhe hidraulike.

Ata mund të punësohen nëpër kompani të automjeteve, në punëtori për rregullimin e automjeteve, kompanitë e transportit, si dhe ato tregtare që bëjnë riparimin e automjeteve, në qendrat e kontrollimit teknik të automjeteve, apo mund të jetë i vetëpunësuar.

Nr.	Funksioni (detyra)	Përshkrimi i funksionit (detyrës)
1	**Organizimi i vendit të punës**	Organizon punën, bën pranimin e automjeteve, trajton klientët, mirëmban vendin e punës, mjeteve dhe pajisjeve, si dhe mban dosje.
2	**Aplikimi i rregullave të sigurisë dhe mbrojtjes në punë përfshirë edhe mbrojtjen e mjedisit**	Identifikon rreziqet në vendin e punës, zgjidhë rreziqet në mënyrë që të mbrohet shëndeti i punëtorëve, duke aplikuar rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes në punë, përfshirë edhe mbrojtjen e mjedisit në vendin e punës.
3	**Diagnostifikimi dhe riparimi i pjesëve/ sistemeve të motorit që punon me lëndë djegëse**	Diagnostifikon, gjen, izolon dhe riparon prishjet duke përdorur sistemet me kompjuter, mjete dhe pajisje tjera; identifikon shkaktarin e prishjes, apo mosfunksionimit të pjesës/ motorit.
4	**Diagnostifikimi dhe riparimi i pjesëve/ sistemeve qarkulluese të automjetit**	Diagnostifikon, gjen, izolon, riparon dhe/ose zëvendëson pjesët/ sistemet duke përdorur sistemet e diagnostifikimit me kompjuter, mjete dhe pajisje tjera; identifikon shkaktarin e prishjes apo mosfunksionimin e pjesës/ sistemit.
5	**Diagnostifikimi dhe riparimi i pjesëve/ sistemeve elektrike**	Diagnostifikon, riparon dhe zëvendëson pjesët/ sistemet elektrike duke përdorur mjete dore dhe pajisje tjera të nevojshme përfshirë edhe sistemet kompjuterike.
6	**Diagnostifikimi dhe riparimi i pjesëve/ sistemeve elektronike**	Diagnostifikon, riparon dhe zëvendëson pjesët/ sistemet elektronike duke përdorur mjete dore dhe pajisje tjera të nevojshme përfshirë edhe sistemet kompjuterike.
7	**Diagnostifikimi dhe riparimi i pjesëve/ sistemeve hidraulike**	Diagnostifikon, riparon dhe zëvendëson pjesët/ sistemet hidraulike duke përdorur mjete dore dhe pajisje tjera të nevojshme përfshirë edhe sistemet kompjuterike.
8	**Ofrimi i shërbimit për goma**	Shërbime për goma, si: ndërrimi i gomave dhe balancimi i rrotave duke përdorur mjete dore dhe pajisje tjera të nevojshme.
9	**Diagnostifikimi dhe riparimi i pajisjeve ndihmëse**	Kontrollon, diagnostifikon dhe riparon sistemet e ngrohjes/ ftohjes; fshesat, pjesët për komfor, etj., duke përdorur mjete dore dhe pajisje tjera të nevojshme.
10	**Zhvillimi profesional**	Ky funksion ka të bëjë me identifikimin e mundësive për avancimin e nivelit profesional dhe intelektual në kuadër të profesionit teknikut të automjeteve.

Funksioni: Organizimi i vendit të punës

Ky funksion ka të bëjë me organizimin e punës, pranimin e automjeteve, bisedën dhe trajtimin e klientëve; shqetësimet e klientëve në lidhje me gjendjen aktuale të automjetit, duke siguruar dokumentet (si dëshmi) për punën (shërbimin) e kryer në automjet, faturat për punën e kryer, si dhe garancitë për shërbimet e ofruara dhe organizimin e bazës së të dhënave.

Aktivitetet kyçe (+ përfundimi i punës / rezultatet)	Kriteret e performancës	Njohuritë e nevojshme për ta kryer punën	Shkathtësitë	Shkathtësitë kyçe që janë të lidhura me funksionin kryesor
Përgatitja e vendit të punës	Mirëmbajtja e mjeteve dhe pajisjeve të punës Mirëmbajtja e mjeteve dhe pajisjeve të diagnostifikimit Mirëmbajtja e mjeteve dhe pajisjeve për siguri dhe mbrojtje në punë	Njohuri për mirëmbajtjen e mjeteve dhe pajisjeve të punës Njohuri për mirëmbajtjen e pajisjeve për kontroll dhe diagnostifikim Njohuri për mirëmbajtjen e pajisjeve për siguri dhe mbrojtje në punë Të jetë i qartë gjatë bisedës me klientët Njohuri se si të organizohet vendi i punës dhe i të dhënave të dosjes. Njohuri se si të llogariten shpenzimet, fitimi, çmimet, mirëmbajtja dhe arkivimi i dokumenteve.	Kryen mirëmbajtjen e mjeteve dhe pajisjeve të punës Kryen mirëmbajtjen e pajisjeve për kontroll dhe diagnostifikim Kryen mirëmbajtjen e pajisjeve për siguri dhe mbrojtje në punë Udhëheqë bisedën me klientë rreth shqetësimeve të tyre në lidhje me prishjen e automjetit të tyre Organizon vendin e punës dhe arkivon të dhënat. Llogaritë shpenzimet gjatë punës dhe kohën e nevojshme për kryerjen e punës Siguron dëshmi dhe garanci për punën e kryer dhe bën pranimin e ankesave.	I hapur për punën në ekip Komunikativ Fleksibil Tolerant I arsyeshëm Kompetent për punën e kryer Flet gjuhë të huaja



Raporti i referencimit të KKK-së së Kosovës me KEK-në mbi Arsimin e Përgjithshëm, AAP-në dhe Arsimin e lartë